



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

Politika Kombëtare e Konkurrencës

POLITIKA KOMBËTARE E KONKURRENCËS

Botimi II

*Miratur nga Komisioni i Konkurrencës, date 06.11.2015,
në zbatim të nenit 24/a, të ligjit nr. 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës"*

Përmbajtja

PARATHËNIE	3
I. Ç' ËSHTË KONKURRENCA?	4
i. Politika e konkurrencës dhe objektivat e saj në kushtet e ekonomisë Shqiptare	4
ii. Liberalizimi dhe politika e konkurrencës	6
iii. Konkurrenca e drejtë dhe e ndershme, rregullimi ligjor dhe institucional i çështjeve të konkurrencës	7
iv. Rregullimi i konkurrencës në rastin e Shqipërisë.....	9
v. Konkurrenca dhe ndihma shtetërore	10
II. POLITIKA E KONKURRENCËS, OBJEKTIVAT DHE MISIONI I SAJ	12
II.1. Nevoja e zbatimit të politikës së konkurrencës	13
II.2 Objektivat e politikës së konkurrencës.....	13
II.3 Qëllimi i hartimit të politikës kombëtare të konkurrencës	14
II.4 Bashkëveprimi i politikës së konkurrencës me politikat e tjera	14
III. MBROJTJA E KONKURRENCËS NË KUSHTET E SHQIPËRISË.....	16
III.1 Konkurrenca si parim bazë i ekonomisë funksionale të tregut	16
III.2 Kushtet ekonomike në të cilat është zhvilluar konkurrenca, ligji dhe politika e konkurrencës në Shqipëri.....	17
III.3 Vështrimi historik për zhvillimin e politikës, legjislationit dhe institucioneve për mbrojtjen e konkurrencës.....	17
III.4 Autoriteti i Konkurrencës si institucion zbatues i politikës dhe ligjit të konkurrencës18	
III.5. Parimet e Autoritetit të Konkurrencës	19
IV. ZBATIMI I POLITIKËS SË KONKURRENCËS	22
IV.1 Format e praktikave anti-konkurrese	22
IV.1.1 Marrëveshjet që kufizojnë konkurrencën.....	22
IV.1.2 Abuzimi me pozitën dominuese	23
IV.1.3 Kontrolli i përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve	24
IV.2 Instrumentet për zbatimin e politikës së konkurrencës.....	25
IV.2.1 Proçedurat hetimore.....	25
IV.2.2 Gjjobat si instrument i zbatimit të politikës së konkurrencës	26
IV.2.3 Programi për lehtësimin nga gjjobat	27
V. POLITIKA E KONKURRENCËS DHE DERREGULLIMI SEKTORIAL	28
V.1 Bashkërendimi i politikës së konkurrencës me politikat publike në sektorët e rregulluar	28
V.2. Konkurrenca në tregjet e rregulluara	30
V.2.1 Sektori i Komunikimeve Elektronike	30

V.2.2	Sektori energjetik	34
V.2.3	Sektori financiar	36
V.2.4	Tregu i sigurimeve	38
V.2.5	Prokurimet Publike	39
V.2.6	Sektori Farmaceutik	41
VI.	AVOKATIA E KONKURRENCËS DHE BASHKËPUNIMI ME ENTET RREGULLATORE	43
VI.1	Avokatia e konkurrencës dhe mjetet në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës ...	43
VI.2	Vlerësimi i projekt-akteve ligjore dhe nënligjore	44
VI.2.1	Kufizimet sasiore	44
VI.2.2	Të drejtat ekskluzive	45
VI.3	Bashkëpunimi me entet rregullatorë	47
VI.4	Krijimi i kulturës së konkurrencës	47
VII.	INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	49
VII.1	Përafrimi i legjislacionit të konkurrencës me atë të BE-së	49
VII.2	Bashkëpunimi me Bashkimin Evropian	50
VII.3	Bashkëpunimi Ndërkombëtar i Konkurrencës (ICN, UNCTAD, OECD)	51
VII.4	Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës	51
VII.5	Marrëdhëniet me të tretët	51
VII.6	Bashkëpunimi në të ardhmen	52
VIII.	DREJTIMET KRYESORE TË RRITJES SË EFEKTIVITETIT TË POLITIKËS DHE TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS	54
VIII.2	Zhvillimet institucionale	55
VIII.3	Zbatimi i ligjit	56
VIII.4	Avokatia dhe rritja e kulturës së Konkurrencës	57
VIII.5	Prioritetet afat-shkurtra të Autoritetit të Konkurrencës	58
VIII.	BIBLIOGRAFI	59

PARATHËNIE

Autoriteti i Konkurrencës, si institucion i pavarur i ndërtuar që të mbrojë dhe të nxisë konkurrencën midis lojtarëve të tregut si dhe të promovojë një ambient ekonomik pro-konkurrues, ka hyrë në dekadën e tij të dytë. Eksperiencat e institucionit të konkurrencës në zbatimin e Politikës Kombëtare të Konkurrencës dhe të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” evidentuan rëndësinë e instrumentave të advokacisë së konkurrencës për rritjen e efikasitetit të ndërhyrjeve të tij për të parandaluar dhe luftuar praktikatat anti-konkurruese.

Në këtë këndvështrim, ribotimi i Politikës Kombëtare të Konkurrencës (2006), në format më gjithëpërfshirës të filozofisë të kombinuar me rastet konkrete të ndërhyrjeve në treg të Autoritetit të Konkurrencës, është konsideruar si një instrument potencial që do të ndihmojë në forcimin e advokacisë dhe të kulturës së konkurrencës, jo vetëm nga komuniteti i biznesit dhe ai i konsumatorit, por edhe nga politikëbërësit, regullatorët dhe akademikët.

Ky botim ka marrë parasysh zhvillimet më bashkëkohore të së drejtës europiane të konkurrencës, praktikatat më të mira, rekomandimet e konkluduar nga analiza e zbatimit të Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës, standardet e zbatuara nga Autoriteti i Konkurrencës, si edhe vlerësimin e realizuar nga ekspertët ndërkombëtarë të UNCTAD-it.

I. Ç' ËSHTË KONKURRENCA?

Konkurrenca është një dukuri ekonomike, që i referohet një gjendjeje të ekonomisë së lirë të tregut, ku firmat, në mënyrë të pavarur, përpiqen të fitojnë sa më shumë blerës, për të arritur objektivat e tyre si p.sh. maksimizimi i shitjeve, pjesëve së tregut, maksimizimi i fitimit etj.

Konkurrenca krijon një mjedis ekonomik ku firmat mund të veprojnë lirisht në arritjen e këtyre objektivave, ndërsa konsumatorët, nga ana e tyre, përfitojnë nga çmimet e vendosura në bazë të bashkëveprimit mes forcave të kërkesës dhe atyre të ofertës.

Konkurrenca nuk është qëllim në vetvete, por një instrument i nevojshëm në arritjen e niveleve më të larta të mirëqenies shoqërore, duke shpërblyer ndërmarrjet që ofrojnë çmime më të ulëta, cilësi më të mirë dhe mundësi më të madhe zgjedhjeje për konsumatorët.

Ajo krijon një klimë pasigurie, e cila i detyron ndërmarrjet që të përshtatin strategji konkurruese agresive, si kundërpërgjigje ndaj lëvizjeve të rivalëve të tyre aktualë ose potencialë, duke ndihmuar kështu, në realizimin e atyre mallrave ose shërbimeve, për të cilat konsumatorët kanë më shumë nevojë.

Nëse mekanizmat konkurrues frenohen nga rregullime kufizuese të panevojshëm, të cilat do të pengojnë hyrjen e ndërmarrjeve më efikente në treg, do të ndodhte edhe frenimi i kërkesës konsumatore, që do të ulte ndjeshëm eficientën e përgjithshme të sistemit ekonomik.

Mungesa e konkurrencës mund të frenojë risitë dhe të pengojë përpjekjet për kërkim dhe zhvillim. Ndërmarrjet që janë pjesë e një tregu konkurrues, kërkojnë risi për të sfiduar ndërmarrjet ekzistuese, që të realizojnë sa më shumë fitim dhe t'i përgjigjen më mirë kërkesës në rritje të tregut. Një mjedis konkurrues siguron se do të ketë më shumë se një hyrës potencial në "garën" për të prodhuar një produkt të ri ose për të ofruar një shërbim më të mirë.

Si rrjedhim, konkurrenca e fuqishme përbën nxitësin kryesor të rritjes së prodhimtarisë dhe siguron që tregu të mbetet konkurrues. Njëkohësisht ajo ka një efekt pozitiv te konsumatorët, sepse këta të fundit përfitojnë nga mundësia e zgjedhjeve, nga cilësia, çmimet e drejta dhe prodhimet e reja.

Konkurrenca përbën nxitësin kryesor të konkurrueshmërisë midis firmave dhe çon në rritjen ekonomike të një vendi. Ajo i detyron të dalin jashtë tregut firmat jo-efikase dhe realizon rishpërndarjen e burimeve prodhuese nga firmat e dështuara te konkurrentët më të fuqishëm.

i. **Politika e konkurrencës dhe objektivat e saj në kushtet e ekonomisë Shqiptare**

Ekonomia shqiptare është një ekonomi e tregut dhe e iniciativës së lirë, fakt i cili është sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 4 i Kushtetutës).

Një nga fenomenet e pashmangshme të ekonomisë së lirë të tregut është loja e lirë

midis lojtarëve të tregut, lojë e cila sjell alokimin eficient të burimeve të shoqërisë.

Teoria ekonomike neoklasike ka argumentuar se sjellja oportuniste për të rritur përfitimet është një fenomen i cili duhet marrë në konsideratë kur studiohet firma, pra jo gjithmonë loja midis lojtarëve të tregut është e barabartë dhe e drejtë. Pikërisht për të mbrojtur konkurrencën (lojën e lirë) nga veprimet anti-konkurrese dhe për ta nxitur atë janë ndërtuar kuadri ligjor dhe institucional, të cilët kanë patur dinamikën e vet historike si në ekonominë mbarë botërore ashtu edhe në ekonominë shqiptare.

Shqipëria konsiderohet relativisht si një ekonomi e vogël dhe e hapur. E vogël për shkak të numrit të popullsisë, pra të konsumatorëve dhe e hapur për shkak të politikës së tregut të hapur, të ndjekur gjatë viteve të fundit. Një nga problemet kryesore që shfaqin ekonomitë e vogla është përqendrimi i tregut. Duke qenë se tregu i shitjes është i vogël, ose e thënë ndryshe, sasia e kërkuar është e kufizuar, ndërmarrjet mund të mos arrijnë të përfitojnë plotësisht nga ekonomitë e shkallës në prodhim dhe shpërndarje. Nga ana tjetër, në një treg të vogël ushtrojnë veprimtarinë e tyre pak ndërmarrje, gjë që sjell dhe një shkallë të ulët konkurrence.

Tregu i vogël dhe izolimi i Shqipërisë në të kaluarën ka sjellë një nivel të ulët investimesh të vendit dhe të huaja, gjë që ndikon në numrin e operatorëve në treg. Megjithatë ekonomia shqiptare mund të quhet si një ekonomi të hapur, përvoja tregon se ka ende pengesa në hyrje.

Përqendrimi i lartë i tregjeve ndikon në zbatimin e politikës së konkurrencës në të tri shtyllat e saj: marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve, trajtimi i ndërmarrjeve që gëzojnë një pozitë dominuese dhe kontrolli i përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve. Nëse politika e konkurrencës ndaj marrëveshjeve horizontale që fiksojnë çmimet duhet të jetë e njëjtë me politikën e ndjekur në nivelin ndërkombëtar, analiza e kufizimeve të konkurrencës dhe peshimi i pasojave negative dhe atyre pozitive duhet të marrin parasysh karakteristikat e ekonomive të vogla.

Marrëveshjet vertikale që kanë si pasojë izolimin dhe ndarjen e tregut shqiptar nga ai rajonal dhe evropian, kanë pasojë më të rënda në vendet e vogla. Nga ana tjetër, në një treg të përqendruar, marrëveshjet horizontale mund të rrisin mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve por, njëkohësisht, mund të rrisin eficientësinë ekonomike, në veçanti eficientësinë e prodhimit.

Marrëveshjet e specializimit mundësojnë specializimin dhe uljen e kostos së prodhimit në një vend ku mungojnë aktivitetet e specializuara dhe ku teknologjitë e reja duan kohë të futen në treg. Këto marrëveshje bëjnë të mundur përmirësimin e procesit të prodhimit dhe të shpërndarjes së ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri, shumica e të cilave përbëjnë ndërmarrje të vogla e të mesme. Sidomos në tregje të reja, ku tregtohen mallra ose prodhime të reja, analiza e pasojave të konkurrencës merr parasysh dhe vlerëson rrezikun për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në këtë rast, edhe marrëveshje që përkohë me një pjesë pak a shumë të rëndësishme të tregut, mund të shihen si të lejueshme, përveç rasteve kur ato çojnë në vendosjen e një çmimi të përbashkët ose në ndarjen e territoreve ose klientelës.

Nevoja për arritjen e një shkalle minimale prodhimi lehtëson krijimin e ndërmarrjeve që kanë një pozitë të fuqishme në treg. Dispozitat e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës,

që trajtojnë praktikat abuzive, mund të zbatohen më shpesh pikërisht për shkak të përqendrimit të tregut. Nëse ligji lejon arritjen e pjesëve të mëdha të tregut për një kohë të gjatë, ai nuk lejon arritjen dhe mbrojtjen e tyre me mjete që nuk përkojnë me konkurrueshmërinë për shkak të meritës. Ligji parashikon si ndalimin e praktikave shfrytëzuese, ashtu dhe ndalimin e praktikave që kanë si pasojë përjashtimin e konkurrentëve nga tregu ose pengimin e futjes në treg.

Problemi i shkallës dhe i pengesave në hyrje kërkon analizë të kujdesshme dhe në kontrollin paraprak të përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve. Megjithatë, kur pengesat në hyrje janë të vogla, gjë që lë të kuptohet arritjen e një tregu gjeografik rajonal, përqendrimet ndërmjet ndërmarrjeve rrezikojnë, në raste më të rralla, të krijojnë ose forcojnë një pozitë dominuese.

ii. Liberalizimi dhe politika e konkurrencës

Pas privatizimit të tregtisë dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme në vitet e para të tranzicionit, liberalizimi dhe privatizimi në vitet e fundit është drejtuar kryesisht ndaj sektorëve strategjikë të shërbimit publik, si: energjia, telekomunikacioni dhe tregu financiar. Hyrja e operatorëve të rinj, zgjerimi i privatizimit, ndërhyrjet për ndarjet vertikale dhe horizontale, progresi teknik dhe rregullimi teknik i sofistikuar kanë ndryshuar me shpejtësi tregjet, veçanërisht në telekomunikacion, ku zhvillimet e konkurrencës janë të ndjeshme dhe të paparashikueshme, ndonëse duhen konsideruar ende të pamjaftueshme për krijimin e një mjedisi plotësisht konkurrues.

Në përgjithësi, këta sektorë trajtohen nga ente rregullatorë të veçantë, të pavarur, por që kanë si objekt kryesor nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive. Megjithëse instrumentet dhe mënyra e ndërhyrjes, në thelb janë të ndryshme, ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës dhe enteve rregullatorë në sektorët specifikë nuk ka kundërshtime thelbësore për sa i takon rregullimit dhe ndërhyrjes në këto tregje. Rregullimi përcakton sjelljet specifike që ndjekin ndërmarrjet në termat e çmimeve finale dhe tarifave të hyrjes, kurse Autoriteti i Konkurrencës ndërhyr nëpërmjet dispozitave të përgjithshme dhe abstrakte, të vlefshme për të gjithë sektorët.

Nga ky këndvështrim, rregullimi shihet nën optikën e një rregullimi ekonomik. Rregullimi ekonomik mbështetet në perspektivën se ndërhyrja në treg është e nevojshme dhe fitim-prurëse vetëm kur ofron zgjidhje për disa natyra të fuqisë së tregut dhe në veçanti, të dështimeve të tregut, të cilat vijnë nga strukturat e mëparshme monopolistike. Zhvillimi i kuadrit analitik për rregullimin ka ecur krah për krah me zhvillimin e strukturave të tregut, nga monopole shtetërore në një mjedis pro-konkurrues, që gjithmonë e më shumë po liberalizohet. Në të njëjtën kohë, i njëjti tip i analizës industriale-ekonomike është bërë emëruesi i përbashkët midis ekonomisë së konkurrencës dhe ekonomisë së rregullimit. Të dyja këndvështrimet ndajnë tani një fokus të mikroekonomisë së zbatuar, organizimit industrial dhe ekonomisë së stimujve. Sidoqoftë është e qartë se, pavarësisht nga këto zhvillime, Shqipëria nuk ka arritur ende kushtet e tregut që do të na lejonin të braktisim një rregullim paraprak (ex-ante). Krahasuar me sektorët e tjerë të ekonomisë, këta sektorë janë ende në një periudhë tranzicioni, ku nevojitet të zbatohen si instrumentet e ligjit të konkurrencës, ashtu edhe rregullimi i sektorëve të veçantë. Gjithashtu vazhdon të ketë mangësi në funksionimin e tregut të komunikimit elektronik sipas mekanizmave të tregut. Për aq kohë sa ekzistojnë probleme të tilla, si pengesat e pajustificuara të hyrjes në rregullim bazë, mbetet i nevojshëm rregullimi

ex-ante. Sidoqoftë, kjo ndërhyrje e fortë në treg, pa dyshim që është mbështetur në parimet e ligjit të konkurrencës dhe në këtë mënyrë, është në përputhje me instrumentet e tij.

Shpesh zotëruesi i infrastrukturës, që vepron në stadet e konkurrencës ka një nxitje të fortë për të diskriminuar konkurrentët, duke përdorur mënyra dhe strategji të reja për përjashtimin e tyre.

Në këto raste, detyrat e rregullimit dhe Autoritetit të Konkurrencës nuk janë më të thjeshta, pra të ndalojnë ndërmarrjen që kontrollon infrastrukturën për të shfrytëzuar fuqinë e saj të tregut në kurriz të klientëve dhe përdoruesve. Politika rregulluese nuk mund të vazhdojë të shihet si e pavarur nga politika konkurruese, ajo duhet të shihet si pjesë e një grupi më të gjerë të instrumenteve të ndërhyrjes në ekonomi, duke u bazuar në parimet e analizës konkurruese.

Nuk duhet të shihet si kontradiktor fakti që rregullimi është përcaktuar gjithnjë e më shumë nga një perspektivë e politikës konkurruese, duke përdorur si mjetet e konkurrencës, ashtu edhe ato rregulluese. Këto shqyrtojnë të njëjtin problem dhe përpiqen të arrijnë të njëjtin synim. Problem është niveli i lartë i fuqisë së tregut dhe mundësia e abuzimit me të. Synimi kryesor është që të vendosen përdoruesit përfundimtarë në qendër të çdo veprimtarie ekonomike.

Sidoqoftë, ka një ndryshim të rëndësishëm midis instrumenteve konkurruese dhe atyre rregullatorë. Sigurisht që instrumentet konkurruese janë dhe do të jenë të zbatueshme, ndërsa instrumentet rregullatorë nevojiten vetëm për aq kohë sa konkurrenca nuk është zhvilluar mjaftueshëm. Rezultatet e veprimit anti-monopol, madje edhe në këtë sektor, janë karakterizuar nga një shkallë e lartë e kompleksitetit teknologjik dhe nga një barrë e rëndë financiare e trashëguar nga e kaluara.

Qëllimi është që të sigurohet përmbushja e objektivave afatgjatë të zhvillimit të konkurrencës në interes të konsumatorëve përfundimtarë. Për aq kohë sa rregullimi është mbështetur fort në rregullat e konkurrencës, ai nuk mund të jetë i dëmshëm për zhvillimin e konkurrencës, ai vetëm mund ta favorizojë atë.

iii. Konkurrenca e drejtë dhe e ndershme, rregullimi ligjor dhe institucional i çështjeve të konkurrencës

Konkurrenca ka një kuptim të gjerë jo vetëm ekonomik por në të gjitha fushat, fenomeni ekonomik i konkurrencës ka nevojë për përcaktime ligjore të qarta dhe institucione funksionale për t'u zbatuar.

Në rregullimin e aspekteve të konkurrencës në ekonomi duhet të kemi parasysh se mënyra e rregullimit të kufizimeve, shtrembërimeve dhe pengimit të konkurrencës varion sipas juridiksioneve të ndryshme.

Nga mënyra e përkufizimit të konkurrencës, rregullimi i saj i referohet gjerësisht formave të ndryshme të sjelljeve anti-konkurruese si p.sh., çështjet e konkurrencës së pandershme, mashtrimi me markat dhe patentat, reklamat mashtruese, produktet e falsifikuara apo të evazionit fiskal dhe kontrabandës, e deri te mashtrimet me cilësinë

dhe çmimet të një konkurenti që dëmtojnë konsumatorët dhe konkurrentët e tij.

Konkurrencë e pandershme është çdo praktikë tregtare mashtruese ose e pandershme që është e ndaluar nga kuadri ligjor në fuqi.

Konkurrenca e pandershme është situata në të cilën konkurrentët konkurrojnë në pozita jo të barabarta, sepse zbatohen kushte favorizuese ose disavantazhe për disa konkurrentë dhe jo për të tjerët. Ky koncept, gjithashtu i referohet situatave në të cilat veprimet e disa konkurrentëve dëmtojnë pozitën e të tjerëve dhe mundësinë e tyre për të konkurruar mbi kushte të barabarta dhe të drejta.

Direktiva e BE-së për konkurrencën e pandershme, përcakton si të tilla ato praktika tregtare, të cilat janë të ndaluara në Bashkimin Evropian, duke mbrojtur interesat ekonomike të konsumatorëve, përgjatë dhe pas kryerjes së një transaksioni tregtar.

Praktika të pandershme konsiderohen ato të cilat nuk përmbushin kriteret e vullnetit profesional dhe me shumë mundësi shtrembërojnë sjelljen ekonomike të një numri të madh konsumatorësh.

Nëpërmjet kuadrit ligjor në fuqi kundër këtyre praktikave të konkurrencës së pandershme, mbrohen një grup i madh konsumatorësh. Dallohen dy kategori të praktikave tregtare të pandershme, *misleading practices* (praktikat shtrembëruese/veprime mashtruese) dhe praktikat agresive.

Praktikat shtrembëruese janë ato të cilat përmbajnë informacion të falsifikuar ose jo të vërtetë, ose praktikat të cilat me shumë mundësi mashtrojnë konsumatorin edhe pse informacioni mund të jetë i saktë dhe që e çojnë atë të ndërmarrë një vendim për një transaksion, që në të kundërt nuk do ta kishte ndërmarrë. Përmendim rastet e informacionit të falsifikuar ose mashtrues lidhur me ekzistencën ose natyrën e produktit, karakteristikat kryesore të produktit (përftimet, riskun, përbërjen, origjinën gjeografike, rezultatet që priten të vijnë nga përdorimi etj.), me çmimin ose me ekzistencën e një avantazhi specifik në çmim, me nevojën për riparime apo servis etj.

Praktikat agresive. Vendimet lidhur me transaksionet e konsumatorëve duhet të kryhen me vullnet të lirë. Ato nuk mund të kryhen si pasojë e ngacmimit, detyrimit apo ndikimit/influencës së tepruar. Elementët që vërtetojnë se ka pasur një praktikë të tillë përfshijnë natyrën, vendndodhjen ose kohëzgjatjen e një praktike të tillë agresive, kërcënimi apo sjellja me një gjuhë kërcënuese apo abuzive; shfrytëzimi nga ana e tregtarit e ndonjë rrethane specifike që ndikon konsumatorin me qëllim që të influencojë në vendimin e tij; kushte jokontraktuale dhe disproporcionale të vendosura mbi konsumatorin i cili dëshiron që të ushtrojë të drejtat e tij kontraktuale (p.sh që të përfundojë apo ndryshojë kontratën.

Bazuar në eksperiencën e disa vendeve të BE-së, ka dy përfaqesja kryesore për të zgjidhur këtë çështje. Nga njëra anë, ka shembuj ku mbrojtja e konsumatorit dhe politika e konkurrencës janë të përqëndruara dhe i jepen një agjencie të aftë për tu marrë me të dyja fushat (Itali, Britani e Madhe, Holandë, Poloni, Danimarkë). Ky opsion lejon përdorimin e burimeve të kombinuara brenda një autoriteti të vetëm në realizimin e objektivave përkatëse të mbrojtjes së konsumatorit dhe politikave të konkurrencës dhe kështu natyra e tyre plotësuese bëhet më e dukshme si për

operatorët ekonomikë ashtu edhe për konsumatorët.

Nga ana tjetër, ka disa vende të BE-së, ku autoritetet e konkurrencës janë të ndryshme nga agjencia, e cila merret me mbrojtjen e konsumatorit (Gjermani, France, Bullgari dhe të tjera) dhe merren ekskluzivisht me çështjet antitrust, kartelet, pozita dominuese dhe kontrolli i përqëndrimeve. Ky opsion kërkon që çdo organ të ketë burime të mjaftueshme, të ketë pavarësi dhe të ketë fuqi mjaftueshëm për të implementuar dhe zbatuar politikat përkatëse për të cilat është përgjegjës.

Në çdo rast, efektiviteti i mbrojtjes së konsumatorëve nuk mund të perceptohet pa përfshirjen aktive të organizatave joqeveritare dhe shoqatave të mbrojtjes së konsumatorëve, të cilat luajnë një rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e informacionit, kryerjen e aktiviteteve të rritjes së ndërgjegjësimit, edukimin e konsumatorëve si dhe lehtësimin e veprimeve të përbashkëta për mbrojtjen e konsumatorëve.

iv. Rregullimi i konkurrencës në rastin e Shqipërisë

Çështjet e konkurrencës së pandershme përfshijnë një spektër të gjerë të praktikave të pandershme tregtare, të cilat shkojnë përtej aspekteve të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe që kryesisht rregullohen nga legjislacioni për mbrojtjen e konsumatorit dhe Kodi Civil.

Për çështjet e konkurrencës së pandershme të një ndërmarrjeje ndaj një ndërmarrjeje tjetër, legjislacioni shqiptar në Kodin Civil, përkatësisht në nenet 638 dhe 639, parashikon konkurrencën e pandershme dhe mënyrën e rregullimit të çështjeve përsa i përket kësaj forme të kufizimeve të konkurrencës.

Për çështjet e praktikave të pandershme tregtare të një ndërmarrjeje ndaj konsumatorit, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes dhe Komisionit të Mbrojtjes Konsumatore të ngritur pranë saj, janë organet publike përgjegjëse për zgjidhjen e problematikës mbi praktikatat e pandershme tregtare.

Rregullimi parashikohet në Ligjin Nr.9902, datë 17.4.2008, “Për Mbrojtjen e Konsumatorit”, neni 13 e në vazhdim: Një praktikë tregtare është e padrejtë kur: a) është në kundërshtim me kërkesat që një tregtar pritët në mënyrë të arsyeshme të zbatojë ndaj konsumatorëve, në përputhje me praktikën e tregtimit të ndershëm dhe/ose me parimin e përgjithshëm të mirëbesimit në fushën respektive të veprimtarisë tregtare; b) dobëson ndjeshëm aftësinë e konsumatorit për marrjen e një vendimi, si pasojë e informacionit të dhënë, duke shkaktuar kështu marrjen e vendimit, të cilin, në të kundërt, nuk do ta kishte marrë.

Praktikat tregtare, që shtrembërojnë sjelljen ekonomike të një grupi konsumatorësh, qartësisht të identifikueshëm, të cilët janë të ndjeshëm ndaj praktikës, mallit ose shërbimit, si pasojë e dobësisë së tyre mendore apo fizike, moshës apo lehtë-besimit, në një mënyrë, të cilën tregtari pritët në mënyrë të arsyeshme ta parashikojë, vlerësohen nga këndvështrimi i konsumatorit të nivelit mesatar të këtij grupi.

Ndërkohë që çështjet e ligjit antitrust, marrëveshjet e ndaluara (kartelet), abuzimi me fuqinë e tregut dhe kontrolli i përqëndrimeve rregullohen nga ligji nr. 9121, datë

28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, i cili parashikon rregullat e sjelljes në treg dhe institucionin e Autoritetit të Konkurrencës si përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës.

v. Konkurrenca dhe ndihma shtetërore

Ndihma Shtetërore është përcaktuar si një avantazh i dhënë në çfarëdo forme mbi një bazë të zgjedhur të ndërmarrjeve nga autoritetet publike kombëtare. Për këtë arsye, subvencionet e dhëna për individët ose masat e përgjithshme të hapura për të gjitha ndërmarrjet nuk përfshihen nga ky ndalim dhe nuk përbëjnë ndihmë shtetërore (shembujt përfshijnë masat e përgjithshme tatimore ose legjislacionin e punësimit).

Një kompani, e cila merr mbështetjen e qeverisë fiton një avantazh mbi konkurrentët e saj. Prandaj, në përgjithësi janë të ndaluara ndihmat shtetërore, me përjashtim të rasteve nëse ajo justifikon zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Për të qenë pjesë e Ndhmës Shtetërore, masa duhet të ketë këto karakteristika:

- të ketë një ndërrhyrje nga shteti ose nëpërmjet burimeve shtetërore i cili mund të marrë forma të ndryshme (p.sh. grante, lehtësim nga interesi dhe taksat, garancitë, pronësia e plotë ose e pjesshme e qeverisë në një kompani, ose ofrimin e mallrave dhe shërbimeve me kushte preferenciale etj.);
- ndërrhyrja i jep marrësit një avantazh në baza selektive, për shembull për kompani të caktuara apo për sektorë të veçantë të industrisë, ose për kompanitë e vendosura në rajone të caktuara;
- konkurrenca ka qenë ose mund të jetë shtrembëruar.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e konkurrencës trajton dy çështje: legjislacionin anti-trust dhe politikën e ndihmës shtetërore. Sa i përket ndihmës shtetërore janë përcaktuar rregulla mbi kushtet në të cilat shtetet anëtare mund t’u ofrojnë ndërmarrjeve të tyre ndihmë shtetërore, pa dëmtuar konkurrencën në tregun e brendshëm.

Detyrimet e Republikës së Shqipërisë në fushën e ndihmës shtetërore rregullohen nga Nenet 70 dhe 71 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Këto nene parashikojnë domosdoshmërinë e përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis* e Bashkimit Evropian, si dhe ngritjen e strukturave të pavarura funksionale të ngarkuara me kontrollin e skemave financiare të ndihmës shtetërore dhe ndihmave individuale që zbatohen në Shqipëri, me kompetencat e mjaftueshme ligjore mbi parandalimin dhe kthimin e ndihmave shtetërore të paligjshme.

Kuadri ligjor në këtë fushë, përfshin Ligjin Nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, dhe tre rregullore në zbatim të tij, të miratuara me Vendime të Këshillit të Ministrave, si dhe një sërë udhëzimesh për aspekte apo kategori të caktuara të ndihmës shtetërore, të miratuara me vendime të Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

Strukturat përgjegjëse për monitorimin e skemave ekzistuese të ndihmës shtetërore, si dhe zbatimin e të gjitha procedurave të legjislacionit për analizën dhe vlerësimin e planeve të reja për ndihmën shtetërore në Shqipëri janë: Komisioni i Ndhmës

Shtetërore, si strukturë vendimmarrëse dhe Drejtoria si strukturë tekniko-organizative në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Sektori i Ndhmës Shtetërore).

Komisioni i Ndhmës Shtetërore (KNSH) përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli i Ministrave me një mandat 4 vjeçar. Kryetar i Komisionit të Ndhmës Shtetërore është Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Komisioni i Ndhmës Shtetërore vepron në zbatim të procedurave të Ligjit Nr. 9374 si dhe Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore”.

II. POLITIKA E KONKURRENCËS, OBJEKTIVAT DHE MISIONI I SAJ

Ligji i parë modern “Për mbrojtjen e Konkurrencës” në Shqipëri u miratua në 28.7.2003 dhe hyri në fuqi në 01.12.2003 ndërkohë që proçesi i ngritjes së institucionit Autoritetit të Konkurrencës u konkludua në datën 3 Mars 2014 që është dhe dita kombëtare e konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës është organ publik, i pavarur, i ngarkuar me kontrollin e zbatimit të këtij ligji në funksion të sigurimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Veprimtaria kryesore përfshin shqyrtimin e marrëveshjeve të ndaluara ose karteleve, ndalimin e abuzimit me pozitën dominuese të ndërmarrjeve, shqyrtimin e përqëndrimeve nëse janë apo kufizojnë konkurrencën. Sipas ndryshimeve të vitit 2010 të bëra në ligjin organik të konkurrencës. Autoriteti shqyrton përshtatshmërinë dhe efektivitetin e të drejtave ekskluzive dhe të koncesioneve me synim ruajtjen e balancës së interesit publik me mbrojtjen dhe ushtrimin e parimeve të konkurrencës.

Organi vendimmarrës i Autoritetit është Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, i cili ka pesë anëtare nga të cilët një është kryetar dhe katër janë anëtarë. Anëtarët e Komisionit zgjidhen nga Kuvendi me jo më shumë se dy mandate pesë vjeçare. Autoriteti ka po ashtu stafin administrativ që përbën Sekretariatit dhe që merret me shqyrtimin e ankesave, kryerjen e hetimeve, përpilimin e raporteve dhe të projekt akteve të Komisionit. Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash bazuar në propozimet e Sekretariatit. Ato janë të detyrueshme për zbatim nga palët private apo institucionet. Vendimet e Autoritetit janë subjekt i ankimit në Gjykatën Administrative në vend dhe mund të shkojnë deri në Gjykatën e Lartë.

Përmes vendimeve të tij Autoriteti dënon shkeljet e konkurrencës dhe detyron palët të zbatojnë rregulla të qarta dhe të ndershme loje në veprimtarinë e tyre ekonomike dhe tregtare.

Politika e konkurrencës përfshin tërësinë e masave dhe të kuadrit ligjor brenda të cilit ndërmarrjet që veprojnë në sektorin privat ose atë publik, mund të ushtrjnë lirisht, mbi baza të një konkurrencë të lirë, efektive e të ndershme, veprimtarinë e tyre ekonomike.

Politika e konkurrencës bazohet në gjykimin se një treg konkurrues çon në arritjen e efijencës prodhuese, duke përmbushur kushtin që çmimi të barazohet me koston totale për njësi të prodhimit, si edhe në efijencën alokative dhe atë konsumatore, duke realizuar kështu, kushtin që çmimi të barazohet me koston marxhinale. Në të kundërt, tregjet jokonkurruese, kryesisht monopolet, nuk japin këto rezultate, prandaj dhe janë përgjithësisht të padëshirueshme për shoqërinë.

Hartimi i politikës kombëtare të konkurrencës bazohet në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe është detyrë e Autoritetit të Konkurrencës. Misioni bazë i politikës së konkurrencës është të korrigjojë shtrembërimet e tregut, duke mbajtur parasysh që një treg konkurrues gjeneron zhvillim dhe rrit mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë sonë.

II.1. Nevoja e zbatimit të politikës së konkurrencës

Në tregjet konkurruese, firmat nxiten për të përfituar fuqi tregu, që u lejon rritjen e plotësimin më të mirë të nevojave të konsumatorëve, duke rezultuar me rritje të mirëqenies. Por përpjekjet që bëjnë firmat për këtë qëllim shpeshherë çojnë në kufizimin e konkurrencës, prirje që bën të domosdoshëm zbatimin e politikës dhe të ligjit të konkurrencës.

Në këtë rast, politika e konkurrencës synon të parandalojë abuzimin e aktorëve të tregut me pozitën dominuese, që ata të lidhin marrëveshje që kanë si objekt ose si pasojë fiksimin e çmimeve ose krijimin e një strukture tregu ku konkurrentët bashkohen (me anë të përqendrimit), duke penguar konkurrencën në të ardhmen.

Nevoja e zbatimit të politikës së konkurrencës është shfaqur që me lindjen e ndërmarrjeve të mëdha në sektorë të ndryshëm ekonomikë. Për herë të parë kjo është zbatuar në SHBA. me anë të aktit *Sherman*, në vitin 1890 dhe më vonë, me aktin *Clyton*. Me gjithë amendimet dhe përshtatjet në dekadat e mëvonshme, edhe sot këto akte vazhdojnë të zbatohen fuqishëm në ekonominë amerikane dhe shërbejnë si shembull për hartimin e ligjeve anti-monopol në vendet e tjera.

Në Evropë politika e konkurrencës filloi të zbatohet menjëherë me krijimin e Evropës së Bashkuar dhe gjeti zbatim në Traktatin e Romës, sidomos në nenin 101 (Mbrojtja kundër marrëveshjeve të fshehta, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara), nenin 102 (abuzimi me pozicionin monopol ose dominues), si dhe nenin 106 në rregullat për kontrollin e përqendrimeve.

Pas viteve 90, me ndryshimet që ndodhën në vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore dhe sidomos me kalimin e tyre në ekonominë e tregut, u bë e domosdoshme që edhe këto vende të përshtatnin dhe zbatonin rregullat e konkurrencës, jo vetëm në sektorin privat të ekonomisë, që sapo kishte filluar të krijohet, por edhe në atë shtetëror, që duhej të përshtatej me rregullat e reja të ekonomisë së tregut.

II.2 Objektivat e politikës së konkurrencës

Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke patur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror mund t'i bëjnë konkurrencës. Prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, abuzimin me fuqinë dominuese, si dhe përqendrimet që rrezikojnë të krijojnë një pozitë dominuese në treg.

Realizimi i këtij objektivi është kusht edhe për rritjen e mirëqenies ekonomike të shoqërisë. Duke nxitur rritjen e konkurrueshmërisë, duke siguruar rregulla të barabarta loje të sjelljes në treg, duke nxitur rinovimin, duke rritur mundësitë e zgjedhjes dhe cilësinë e prodhimeve dhe të shërbimeve, si dhe duke arritur në ekuilibër tregu, që prodhojnë çmime sa më reale, politika e konkurrencës bëhet një faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit.

Hartimi i politikës kombëtare të konkurrencës mban parasysh kushtet ekonomike e shoqërore, si dhe kulturën e konkurrencës në vendin tonë. Kjo bën të domosdoshme që, përveç objektivave të përgjithshme për periudhën e kohës për të cilën hartohet ky dokument të vihet theksi edhe në disa objektiva të tjera, siç janë:

- të mbrojtë lirinë e veprimtarisë ekonomike të pjesëmarrësve në treg;
- të reduktojë barrierat e hyrjes në treg, që të krijohet një mjedis i përshtatshëm për nxitjen e sipërmarrjes dhe rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- të nxis proceset e derregullimit dhe të liberalizimit në disa segmente tregu të sektorëve të veçantë, kryesisht të atyre të rregulluara.

Autoriteti i Konkurrencës duhet të japë ndihmesën e vet në këto procese, duke mbështetur zgjidhje që përcaktohen nga tregu, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në zhvillimin e politikave publike dhe dhënies së mendimeve si dhe ndërhyrjes në procedurat e rregullimit. Kjo është e nevojshme sidomos kur bëhet fjalë për rregullimin dhe privatizimin e monopoleve shtetërore apo të të ashtuquajturve “kampionë kombëtarë”, ku Autoriteti i Konkurrencës ndikon në zbatimin e politikave pro-konkurrese.

Duke synuar rritjen e konkurrueshmërisë në ekonominë e vendit, politika e konkurrencës mund të japë një ndihmesë mjaft të rëndësishme në përmirësimin e treguesve makroekonomikë, si në nivelin e përgjithshëm të çmimeve, në punësimin dhe rritjen ekonomike.

II.3 Qëllimi i hartimit të politikës kombëtare të konkurrencës

Qëllimi kryesor i hartimit të dokumentit të politikës së konkurrencës është që të shërbejë si një program dhe të përshkruajë se çfarë duhet të bëhet në lidhje me nxitjen e një konkurrence efektive në treg me anë të pyetjeve pse, ku, çfarë nga kush dhe kur. Përveç kësaj, ky dokument i shërben edhe komunikimit me konsumatorin, me komunitetin e biznesit dhe institucionet publike.

Publiku i gjerë duhet të njihet me qëllimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe objektivat që i vë vetes institucioni i ngarkuar për zbatimin e këtij ligji.

Hartimi i politikës kombëtare të konkurrencës rrit ndërgjegjshmërinë për mbrojtjen dhe nxitjen e konkurrencës. Kjo politikë parashton parimet që përmban ligji, përparësitë në zbatimin e tij, politikën që do të ndjekë Autoriteti i Konkurrencës si dhe parimet kryesore që duhet të respektohen nga të gjithë aktorët e tregut: bizneset dhe institucionet publike.

II.4 Bashkëveprimi i politikës së konkurrencës me politikat e tjera

Megenëse konkurrenca është e pranishme në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit, është e kuptueshme që politika e konkurrencës dhe legjislacioni përkatës zbatohet në të gjitha veprimtaritë ekonomike dhe sektorët. Kjo bën që politika e konkurrencës të ketë një ndërveprim të madh me politikat e tjera publike.

Ka fusha në të cilat objektivat përkatëse mund të jenë komplementare ose në kundërvënie, si në rastin e nismave shtetërore që kanë të bëjnë me derregullimin apo privatizimin e ndërmarrjeve publike. Në këto raste duhet mbajtur parasysh që privatizimi i ndërmarrjeve në tregje të vogla dhe me cikël të mbyllur, mund të paraqesë rrezik mjaft të madh të përqëndrimit në këta sektorë. Prandaj, në procesin e hartimit të strategjive të privatizimit dhe të liberalizimit të këtyre sektorëve, duhet të mbahen parasysh objektivat e ligjit dhe të politikës së konkurrencës.

Ka fusha të tjera, si tregtia, investimet e huaja apo rregullimet rajonale, ku mund të shfaqen mospërputhje midis politikave të ndjekura dhe politikës së konkurrencës. Këtu mund të përmendim rregullat anti-dumping, zbatimin e të cilave mund të ketë efekte anti-konkurrese. Nga perspektiva ligjore këto rregulla lejojnë praktika të tilla, siç janë fiksime çmimesh apo kufizime sasiore tregtare, të cilat mund të jenë të ndaluara nga ligji i konkurrencës. Por, nga pikëpamja ekonomike, këto politika ndjekin objektiva të ndryshme, që shpeshherë mund të çojnë në rrethana konfliktuale. Anti-dumping-u përfshin një sërë klauzolash tregtare për të lehtësuar industrinë vendase në procesin e konkurrencës në import. Qëllimi përfundimtar i politikës së konkurrencës është nxitja e mirëqenies konsumatore dhe e efikasitetit prodhues, e cila varet pjesërisht nga veprimi i faktorëve në treg, brenda të cilit konkurrenca në fushën e importit shpesh herë luan rol mjaft të rëndësishëm.

Politika e konkurrencës lidhet ngushtë me politikën e ndihmës shtetërore. Kjo e fundit mund të vendosë ndërmarrje të veçanta në pozita më të favorshme ndaj të tjerave, duke ndikuar në kufizimin e konkurrueshmërisë midis tyre. Prandaj, në hartimin e politikës së ndihmës shtetërore duhet të mbahen parasysh rëndësia, ligji dhe politika e konkurrencës.

Politika e konkurrencës, së bashku me politikën monetare, fiskale dhe ato tregtare, është quajtur si guri i katërt i themelit të politikave publike. Nisur nga kjo, është e nevojshme që parimet kryesore të saj të mbahen parasysh nga agjencitë e ndryshme publike në hartimin dhe zbatimin e politikave të tjera ekonomike, për të harmonizuar objektivat e tyre me ato të politikës së konkurrencës.

Politika e konkurrencës mund të përdoret si një udhëzues edhe për hartimin e strategjive të enteve rregullatorë për sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe për këtë merr një rëndësi mjaft të madhe bashkëpunimi me entet rregullatorë, për të cilin flitet më poshtë në këtë dokument të politikës së konkurrencës si pjesë e strategjisë së zhvillimit.

III. MBROJTJA E KONKURENCËS NË KUSHTET E SHQIPËRISË

III.1 Konkurrenca si parim bazë i ekonomisë funksionale të tregut

Në një ekonomi tregu, janë kërkesa dhe oferta për një produkt apo shërbim që duke vepruar së bashku në treg përcaktojnë çmimet, të cilat nga ana e vet luajnë një funksion të rëndësishëm për këmbimin e këtyre mallrave apo shërbimeve. Çmimet ju tregojnë prodhuesve se cilat janë ato degë të ekonomisë në të cilat ato mund të realizojnë përdorimin në mënyrën më eficiente të mundshme të faktorëve të prodhimit që ato zotërojnë. Nga ana tjetër ato (çmimet), ju tregojnë konsumatorëve se si ato mund të plotësojnë kërkesat e tyre në mënyrën më ekonomike.

Konkurrenca nënkupton që kompani (apo ndërmarrje) të ndryshme mund të konkurrojnë midis tyre në favor të konsumatorëve apo klientëve të tyre. Konsumatorët ose klientët mund të zhvendosen drejt një kompanie tjetër për të ofruar apo për të blerë mallra apo shërbime në çmime apo në kushte më të mira.

Pra, është presioni i krijuar nga konkurrenca që nga njëra anë i nxit ofruesit që të ulin çmimet, të përmirësojnë cilësinë apo të përsosin teknikat e prodhimit dhe nga ana tjetër konsumatorët në mënyrë të veçantë, përfitojnë nga një treg konkurrues sepse ato mund të zgjedhin nga një rang i gjerë mallrash apo shërbimesh.

Kompanitë që ju ofrojnë konsumatorëve të tyre shërbime të mira me çmime të arsyeshme, në krahasim me kompani të tjera, mund të realizojnë xhiro dhe fitime më të larta në një treg konkurrues. Në një situatë konkurruese, shërbime të dobëta apo çmime të "tepërta" (*eksesive*), janë të destinuara që të përballen me humbje ose me eliminim nga tregu.

Çdo kompani që ka për qëllim maksimizimin e fitimit të saj, duhet tu përgjigjet dëshirave apo preferencave të anës së kundërt të tregut, pra të kërkesës për produktet apo shërbimet që ato ofrojnë. Për këtë arsye, konkurrenca, mund të përshkruhet si forca lëvizëse e ekonomisë së tregut.

Një sistem ekonomik, që bazohet në parimin e konkurrencës dhe në mekanizmat nxitës që rezultojnë nga ajo, është më i mirë për të arritur qëllimet ekonomike, do të thotë, mirëqenie për shoqërinë dhe përparim teknologjik.

Siç përmendëm më lart, konkurrenca çon në përfitime të konsiderueshme për ekonominë si një e tërë. Të gjithë lojtarët e tregut, prodhuesit, tregtarët, ofruesit e shërbimeve dhe në mënyrë të veçantë konsumatorët, përfitojnë nga çmimet dhe ulja e kostove, përmirësimet në cilësi si edhe nga mundësitë e zgjedhjes.

Megjithatë për ndërmarrjet individuale të cilat konkurrojnë me ndërmarrje të tjera në tregjet përkatëse, konkurrenca mund mos të jetë e përshtatshme. Prandaj ka gjithmonë nxitës për ndërmarrjet që të pengojnë apo të eliminojnë konkurrencën. Këto pengesa mund të marrin formën e marrëveshjeve me konkurrentët, praktikave abuzive apo edhe të përthithjes së ndërmarrjeve të tjera, që në rastin ekstrem mund ta eliminojnë tërësisht konkurrencën.

Me qëllim që të parandalohen këto kufizime të konkurrencës dhe të ruhen përfitimet që vijnë nga ajo, është e nevojshme ekzistenca e një kuadri ligjor i cili nga njëra anë kufizon atë aktivitet ekonomik që çënon lirinë e veprimeve të tjerëve dhe nga ana tjetër, mbron strukturat konkurruese në treg (apo tregjet përkatëse).

Konkurrenca ekonomike, pra mund të funksionojë vetëm n.q.s. ka rregulla që gjithsekush mund t'i kontrolloj. Në Republikën e Shqipërisë, këto rregulla vendosen nga ligji 9121 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" i cili nga ana tjetër siguron kuadrin ligjor

brenda të cilit mund të operojnë pjesëmarrësit e tregut. Që në vitin 2004, është detyrë e Autoritetit të Konkurrencës që të zbatojë këtë ligj dhe në këtë mënyrë të mbrojë konkurrencën në vendin tonë.

III.2 Kushtet ekonomike në të cilat është zhvilluar konkurrenca, ligji dhe politika e konkurrencës në Shqipëri

Për shkak të problemeve të trashëguara nga e kaluara, ekonomia shqiptare ka nevojë për një rritje të shpejtë në vitet që vijnë, për të ngushtuar hendekun midis nivelit të të ardhurave për frymë dhe nivelit mesatar të të ardhurave në Evropë. Shqipëria ka bërë progres në reformat strukturore drejt krijimit të një ekonomie me bazë tregun e lirë.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar ndryshimeve institucionale, përfshirë ngritjen e enteve rregullatorë, miratimin e ligjeve organike, ngritjen e institucioneve dhe hartimin e politikave që mbështetin tregjet dhe realizojnë ndërhyrjen e shtetit për t'iu përgjigjur shtrembërimeve të tregut.

Ndryshimet institucionale në lidhje me vetë ndërmarrjet dhe biznesin, në kuadrin ligjor, financiar e shoqëror, që mbështetin procesin e tregut dhe të sipërmarrjes, përbëjnë thelbin e tranzicionit. Në këtë rrafsh, sfida kryesore për sot dhe në të ardhmen është konsolidimi i një ekonomie funksionale tregu, e aftë t'u bëjë ballë presioneve konkurruese dhe forcave të tregut në Bashkimin Evropian, ekonomisë rajonale dhe asaj globale.

Më 24 qershor 2014 Shqipëria mori statusin e vendit kandidat pas një procesi relativisht të gjatë të zbatimit të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Hapja e negociatave për anëtarësim do të shënojë një sfidë për Autoritetin e Konkurrencës si drejtues i kapitullit 8, "Politika e Konkurrencës" jo vetëm për fushat që mbulon ligji "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" por edhe sa i përket ndihmës shtetërore dhe liberalizimit të tregjeve.

III.3 Vështrimi historik për zhvillimin e politikës, legjislationit dhe institucioneve për mbrojtjen e konkurrencës

- Më 7 dhjetor 1995 u miratua ligji nr. 8044 "Për konkurrencën", me të cilin mbyllet faza e institucionalizimit të politikës së konkurrencës në vendin tonë. Drejtimi kryesor i politikës të shtetit në këtë periudhë ishte krijimi i kushteve për veprimin sa më mirë dhe më të plotë të konkurrencës së lirë. Ligji trajtonte çështjet që lidhen me monopolet e pozicionin dominues, si dhe ato të konkurrencës së pandershme.
- Më datë 28.07.2003 u miratua ligji aktual Nr. 9121 "Për mbrojtjen e Konkurrencës", një ligj bashkëkohor dhe i përfaruar në një shkallë të gjerë me legjislationin evropian në fushën e konkurrencës. Ligji i ri nr. 9121, datë 27.08.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", hyri në fuqi në 1 dhjetor 2003 dhe kishte objektiv kryesor mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, përcaktimin e rregullave të sjelljes për ndërmarrjet, si dhe përcaktonte kuadrin institucional përgjegjës për mbrojtjen e parimeve të konkurrencës në Shqipëri. Ligji promovon dhe mbron konkurrencën në treg duke rivendosur konkurrencën dhe duke ndëshkuar sjelljet anti- konkurruese të ndërmarrja nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në treg.

- Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar) është amenduar në datë 3.4.2006, me ligjin nr. 9499 " Për disa ndryshime në ligjin 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës". Sipas këtij amendimi, ndryshimet prekin nenet që bëjnë fjalë për kushtet për t'u zgjedhur anëtarë të komisionit dhe për lirimin e tyre nga detyra. Ligji është prekur dhe nga ndryshimi në lidhje me kompetencat e Komisionit të Konkurrencës, me anë të ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat në institucionet e pavarura të krijuara me ligj". Ndryshimet kanë të bëjnë në tërësi me pjesën që i përket organizimit dhe funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe jo me rregullat e fushës apo me instrumentet për ndalimin e praktikave anti-konkurrese.

Me synimin për të arritur një përafrim të plotë të kuadrit ligjor në fushën e konkurrencës dhe për të përmirësuar zbatimin në praktikë të ligjit duke pasqyruar problematikat e shfaqura gjatë viteve të zbatimit të ligjit dhe rritjen e zbatueshmërisë së parimeve të konkurrencës, në vitin 2010 u miratuan disa amendime të ligjit të konkurrencës. Me ligjin nr. 10317, datë 16.09.2010 'Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 'Për Mbrojtjen e Konkurrencës, të ndryshuar", u miratuan ndryshimet e reja ligjore në fushën e konkurrencës. Në bazë të këtyre ndryshimeve, ligji i konkurrencës tashmë zbatohet edhe për ndërmarrjet publike dhe ato ndërmarrje, të cilave iu është dhënë nga shteti e drejta ekskluzive apo të veçanta për të ushtruar një aktivitet ekonomik të caktuar. Në këtë mënyrë ligji i konkurrencës zbatohet edhe për ato ndërmarrje të cilave iu është besuar kryerja e aktiviteteve me interes të përgjithshëm ekonomik, apo që kanë karakterin e monopoleve të orientuara drejt sigurimit të të ardhurave, për sa kohë dhe në atë masë që në ligj dhe në fakt nuk pengohet veprimtaria e tyre. Nëpërmjet këtij parashikimi, Autoriteti i Konkurrencës ka detyrën për të vlerësuar kontratat publike dhe koncesionet e dhëna nga qeveria ndërmarrjeve të caktuara. Për sa i takon marrëveshjeve të ndaluara, Autoriteti i Konkurrencës me ndryshimet e vitit 2010, ka tagrin për të dhënë përjashtime nga ndalimet, jo vetëm për marrëveshjet individuale por edhe për marrëveshjet në bllok. Politika sanksionuese e institucionit ka ndryshuar, duke hequr nivelin minimal prej 2%, dhe duke vendosur vetëm nivel maksimal ndëshkimi deri në 10%.

Kuadri ligjor në fushën e marrëveshjeve të ndaluara, abuzimit me pozitën dominuese si dhe për kontrollin e përqendrimeve tashmë është i përfaruar me standardet evropiane. Në tërësinë e tij, legjisllacioni shqiptar në fushën e konkurrencës është në një shkallë të lartë i përafruar me legjisllacionin evropian.

III.4 Autoriteti i Konkurrencës si institucion zbatues i politikës dhe ligjit të konkurrencës

Në përputhje me kërkesat e ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës", në shkurt të vitit 2004, përfunduan procedurat për zgjedhjen e anëtarëve dhe të kryetarit të parë të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në propozimet e Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit.

Me këtë akt, nga data 26.02.2004 filloi zyrtarisht veprimtarinë e tij Autoriteti i Konkurrencës, si institucion i pavarur publik, përgjegjës për kontrollin e zbatimit të

rregullave të konkurrencës. Ai përbëhet nga Komisioni i Konkurrencës, si organ vendimmarrës dhe nga Sekretariati, si organ ekzekutiv.

Komisioni i Konkurrencës vepron si një strukturë e përhershme dhe ka të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimit me nismën e tij për çështjet që kufizojnë, pengojnë apo deformojnë konkurrencën në treg, si për ndërmarrjet private ashtu dhe për ato publike, si dhe të propozojë masat e nevojshme për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive. Komisioni i Konkurrencës paraqet në Kuvend raportin vjetor të punës së Autoritetit.

Për të ushtruar si duhet kompetencat e veta ligjore, Autoriteti ka kërkuar të ketë stafin dhe ekspertizën e mjaftueshme, si dhe ka synuar të mundësojë angazhimin efektiv të tyre.

Autoriteti i Konkurrencës ka shënuar progres të dukshëm në zbatimin e ligjit dhe politikës së konkurrencës sipas raporteve periodike të Komisionit Evropian. Sipas raportit të fundit, nëntor 2015, ka patur progres të moderuar në politikën e konkurrencës. Progres është bërë në veçanti për sa i përket antitrust- it dhe kontrollit të përqendrimeve.

Sipas raportit, Autoriteti i Konkurrencës (AK) miratoi udhëzimet për vlerësimin dhe abuzimin me pozitën dominuese në treg në lidhje me antitrust dhe përqendrimet, dhe ka hartuar udhëzime të reja mbi kushtet detyruese në bazë të njoftimit të Komisionit Evropian mbi kushtet detyruese.

Kapaciteti administrativ i AK-së është i mjaftueshëm dhe stafi i saj ka një nivel të mirë të ekspertizës. Megjithatë, vonesat në proceset gjyqësore janë shumë të gjata dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme për të rritur disponueshmërinë dhe cilësinë e trajnimeve për gjyqtarët mbi politikën e konkurrencës.

Sa i përket liberalizimit, vlerëson Komisioni Evropian, një vlerësim ex post i Autoritetit të Konkurrencës zbuloi se autoritetet kontraktuese nuk e kishin përmbushur detyrimin e tyre për të kërkuar një vlerësim nga Autoriteti i Konkurrencës për dhënien e të drejtave ekskluzive.

Në vitet e fundit Autoriteti i Konkurrencës ka shtuar në strukturë një pozicion inspektori dhe aktualisht në Autoritet janë të punësuar 37 persona.

III.5. Parimet e Autoritetit të Konkurrencës

(i) Pavarësia

Ruajtja dhe garantimi i pavarësisë në punën e Autoritetit nga grupet e interesit apo nga ekzekutivi janë thelbësore që puna të kryhet siç duhet. Pavarësia është dhënë me ligjin themelues të institucionit dhe shprehet edhe në garancitë kushtetuese që Komisioni i Konkurrencës ka në marrëdhëniet e tij me Kuvendin dhe qeverinë. Respektimi i Ligjit në përputhje me procedurën të qarta dhe të konsoliduar administrative, pajisja me një staf administrativ të aftë dhe kompetent, ndarja e hetimit nga vendimmarrja dhe transparenca në marrjen e vendimeve, forcojnë pavarësinë dhe besueshmërinë e institucionit.

(ii) Barazia

Zbatimi i parimeve të konkurrencës në mënyrë të tillë që nuk lejon diskriminim të ndërmarrjeve ekonomike në rrethana të njëjta. Kjo sigurohet nga garanci procedurale që zbatohen në procesin e hetimit dhe të vendimmarrjes që respektojnë standardet më të larta të mos-diskriminimit të një procedure administrative.

(iii) Gjithë-përfshirja

Gjithë-përfshirja nënkupton një zbatim të gjerë të parimeve rregullatore dhe të konkurrencës në veprimtari ekonomike, ku hyjnë mallrat, shërbimet, veprimtaritë e biznesit privat dhe atij publik, njohjen e përmasave të konkurrencës në politikat e zhvillimit dhe reformat që ndikojnë në funksionimin eficient të tregjeve, mbrojtjen e procesit të konkurrencës dhe krijimin e ruajtjen e një mjedisi për konkurrencë të lirë dhe efektive. Përfshirja e grupeve të interesit dhe e palëve të interesuara zbatohet në vijimësi në praktikën e punës së Autoritetit.

(iv) Transparenca

Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, Autoriteti i Konkurrencës duhet të jetë i hapur, duke treguar shkaqet për vendimet e marra, si dhe duke informuar vazhdimisht për veprimtarinë dhe rezultatet e arritura. AK përgjigjet para publikut nëpërmjet raportimit të përvitshëm në Kuvend, deklaratave dhe njoftimeve për shtyp e në faqen e internetit, konferencave të shtypit etj. Proçedurat e mbledhjeve të Komisionit të Konkurrencës zbardhen vazhdimisht dhe të gjitha vendimet e tij botohen në faqen zyrtare të internetit www.caa.gov.al dhe janë të disponueshme nga të gjithë.

(v) Përgjegjshmëria

Kërkohet përgjegjësi e qartë e administratës për zbatimin e rregullave të konkurrencës dhe efikasitetin në zhvillimin e politikave dhe administrimin e tyre. Autoriteti i Konkurrencës do të veprojë në përputhje e në harmoni me ligjin, rregulloret e brendshme, strategjitë kombëtare dhe ato sektoriale të zhvillimit ekonomik e shoqëror, në funksion të zbatimit të detyrës

.

(vi) Një institucion i besueshëm

Veprimtaria e institucionit do të krijojë besueshmërinë për vërtetësinë e deklarimeve dhe të vendimeve, duke u bazuar në studime të vazhdueshme dhe në marrjen parasysh të opinioneve të aktorëve të tregut. Autoriteti i Konkurrencës vepron në bazë të parimit të ndershmërisë, ndërmerr vendime dhe publikon të dhëna të sakta për veprimtarinë e tij. Besueshmëria buron nga ndarja e punëve brenda Autoritetit në hetim dhe vendimmarrje, në transparencën e komunikimit me palët si edhe në pavarësinë tonë institucionale.

(vii) Një institucion me integritet

Institucioni nuk duhet ta vendosë veten në detyrime financiare ose të llojeve të tjera, që mund të ndikojnë negativisht ose ta pengojnë atë në kryerjen e detyrave kryesore. Autoriteti i Konkurrencës shpjegon çdo vit para Kuvendit përdorimin e burimeve financiare të akorduara nga buxheti i shtetit, si dhe mban raporte të qarta financiare, të cilat kontrollohen periodikisht nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

(viii) Një institucion bashkëpunues

Puna e institucionit mbështetet në parimin e bashkëpunimit me të gjithë aktorët dhe faktorët e tregjeve, me institucionet kushtetuese, qeverinë, entet rregullatorë, me përfaqësuesit e konsumatorëve, me institucionet homologe rajonale, si dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Konkurrencës në Komisionin Evropian.

IV. ZBATIMI I POLITIKËS SË KONKURRENCËS

IV.1 Format e praktikave anti-konkurrese

Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” synon arritjen e objektivit për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, duke vepruar kryesisht ndaj pengesave artificiale që rritin fuqinë e tregut të ndërmarrjes, që çon në kufizime të konkurrencës. Po kështu vepron ndaj sjelljeve abuzive dhe përqendrimeve për të krijuar e forcuar një pozitë dominuese, që çojnë në rritjen e çmimeve për konsumatorin, kufizimin e prodhimit dhe të mundësisë së zgjedhjes së prodhimeve, në kufizimin e novacionit, të shërbimit ndaj klientit dhe në përgjithësi, në ulje të mirëqenies së konsumatorit.

IV.1.1 Marrëveshjet që kufizojnë konkurrencën

Prirjen për marrëveshje të ndaluara e ka përshkruar Adam Smith në veprën “Pasuria e kombeve”¹³. Në një treg me sjellje konkurruese, prodhuesit, duke u nxitur nga interesi vetjak për të rritur sa më shumë fitimin e tyre, konkurrojnë lirisht me njëri-tjetrin, duke sjellë rritjen e prodhimit në favor të konsumatorëve. Ndërsa, kur prodhuesit kanë qëllim të kufizojnë konkurrencën, duke bashkërenduar veprimet e tyre me anë marrëveshjesh të fshehta, që synojnë fiksimin e çmimit dhe të kushteve të tjera të tregtimit, niveli i prodhimit ulet dhe si rregull, konsumatorët duhet të paguajnë më shumë.

Parashikimet e marrëveshjeve të ndaluara janë në nenin 4 të ligjit.

- Caktimi i çmimeve është një element klasik thuajse për të gjitha rastet e karteleve. Në këtë mënyrë, konkurrentët përpiqen të shmangin konkurrencën e çmimit midis tyre në dëm të konsumatorëve, duke zbatuar çmime më të larta.
- Mënyrë tjetër e fiksimit të çmimit vërehet në një marrëdhënie vertikale, kur një ofrues shërbimi ose prodhues përpiqet ta detyrojë shpërndarësin që të zbatojë një çmim të dhënë për prodhimet e tij. Kjo sjellje është e paligjshme dhe përfshihet në kufizimet e rënda të konkurrencës.
- Nxitësit në një marrëveshje të fshehtë (kartel) mbi të gjitha janë të pranishëm në tregjet e pakicës si për prodhimet, ashtu dhe për shërbimet, ku ndërmarrjet përgjithësisht konkurrojnë më shumë mbi bazën e çmimit se sa të cilësisë. Si rrjedhim i këtyre sjelljeve, konsumatorët detyrohen të paguajnë çmime më të larta se niveli konkurrues. Të tilla marrëveshje horizontale, që nuk mund të justifikohen në termat e efijencës, duhen ndaluar.
- Kufizimi i prodhimit ose ndarja e tregjeve është një formë tjetër e marrëveshjeve mes firmave që çënon rëndë konkurrencën. Ndërmarrjet mund të vendosin të ndajnë tregjet sipas ndarjes gjeografike ose të ardhurave, ose dhe burimet e furnizimit me synim pengimin e hyrjes së konkurrentëve të rinj në treg dhe mbajtjen e nivelit të çmimeve mbi atë ekuilibër në rast të funksionimit të lirisë së tregut.
- Aplikimi i kushteve të ndryshme për transaksione të njëjta me palët duke i

¹ Konkurrenca është gjithçka”, nga Hohn Vickers, The Economist, 6-12 dhjetor 2003, fq74

vendosur në gjendje të pafavorshme të konkurrencës ose kushtëzimi i lidhjes së kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë janë forma më të vështira për tu evidentuar të marrëveshjeve të ndaluara por gjithsesi klasifikohen si shkelje e rëndë e ligjit dhe dënohen me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore.

Marrëveshjet që përjashtohen

Jo të gjitha marrëveshjet që përmbajnë në objektin ose qëllimin e tyre kufizime të konkurrencës janë të ndaluara. Janë disa lloje të marrëveshjeve që përfitojnë nga përjashtimi, në mënyrë të veçantë marrëveshjet e specializimit dhe racionalizimit, marrëveshjet e kërkim-zhvillimit dhe marrëveshjet e blerjes së përbashkët. Këto lloj marrëveshjesh mundësojnë arritjen e efikasitetit ekonomik.

Kushtet për përjashtim:

- marrëveshja pranohet vetëm atëherë kur efektet negative të saj mbi konkurrencën janë më të vogla se ato pozitive;
- marrëveshja duhet të kontribuojë në përmirësimin e prodhimit, shpërndarjes së prodhimit apo promovimit të progresit teknik ose ekonomik;
- konsumatorët duhet të marrin një pjesë të barabartë të përfitimeve të nxjerra;
- kufizimi duhet të jetë i domosdoshëm për arritjen e këtyre objektivave;
- marrëveshja nuk duhet të japë palëve mundësinë të eliminojnë konkurrencën në lidhje me pjesën thelbësore të prodhimit në fjalë.

IV.1.2 Abuzimi me pozitën dominuese

Pozitë dominuese sipas nenit 3 pika 5 e Ligjit, është pozita e një ose më shumë ndërmarrjeve, që i lejon ato të jenë të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët. Një ndërmarrje mund të zotërojë një pozitë dominuese individualisht, ndërsa dy ose më shumë ndërmarrje zotërojnë një pozitë dominuese të përbashkët (dominancë kolektive). Në këto raste, ndërmarrjet priren të bashkërendojnë sjelljen e tyre në treg, për sa u takon çmimeve, sasisë së ofruar, prodhimit apo kapaciteteve të reja të sjella në treg.

Pozita dominuese individuale ose e përbashkët trajtohen si nga ana e ofertës, ashtu edhe nga ana e kërkesës. Në shumicën e rasteve fuqia e tregut ushtrohet nga ofruesit, por kjo mund të ushtrohet dhe nga blerësit (fuqia e blerësit). Ky përkufizim është në përputhje me jurisprudencën evropiane².

Një ndërmarrje e caktuar mund ta zotërojë tregun kur e ka fuqinë e tregut, e cila

² Vendimi i Gjykatës, 14.02.1978, kompanitë UB dhe UBC, Çikita Bananas, fq 65, ku thuhet “një pozitë fuqie ekonomike që i jep mundësi një ndërmarrjeje të pengojë mbajtjen e një konkurrence efektive në tregun përkatës duke e lejuar atë të silltet në mënyrë mjaft të pavarur kundrejt konkurrentëve të saj dhe klientëve, dhe së fundi, kundrejt konsumatorëve».

kuptohet si mundësia e ndërmarrjes të vendosë për një kohë të gjatë çmime më të larta se në një situatë konkurrence dhe të fitojë më shumë se normalisht³.

Ligji nuk parashikon kufi të pjesës së tregut për përcaktimin e një ose disa ndërmarrjeve me pozitë dominuese por praktika gjyqësore evropiane prezumon se një ndërmarrje ka pozitë dominuese kur zotëron më shumë se 50 % të tregut dhe duhen verifikuar faktorë të tjerë pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqinë ekonomike, fuqinë kundërvepruese të blerësve etj., në rastet kur zotëron më shumë se 40 % por më pak se 50 për qind të tregut.

Ligji për mbrojtjen e konkurrencës në nenin 9 ndalon abuzimin e pozitës dominuese, por jo pozitën dominuese në vetvete. Praktika abuzive, ndër të tjera, përbëjnë çmimet e padrejta, kufizimi i prodhimit, kufizimi i tregjeve e i zhvillimit teknik, vendosja e kushteve diskriminuese ose të pabarabarta në marrëveshjet me konkurrentët, dhe vendosja e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera me kusht që këto të fundit pranojnë detyrime shtesë të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.

Format kryesore të abuzimit me pozitën dominuese janë parashikuar në udhëzimin “Mbi vlerësimin e pozitës dominuese dhe abuzimit me pozitën dominuese” miratuar me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 332 datë 09.10.2014. Ky udhëzim është i përshtatur nga rregullorja 2009/C/45/02/OJC/45 e datës 24.2.2009 e Komisionit Evropian në zbatim të nenit 102 TFEU për sjelljet abuzive nga ndërmarrjet dominuese.

Format specifike të abuzimit me pozitën dominuese janë marrëveshjet ekskluzive, blerjet ekskluzive, uljet/skontot e kushtëzuara, shitjet të lidhura/të kushtëzuara ose të grupuara, çmimet grabitqare, refuzimi për të ofruar etj.

IV.1.3 Kontrolli i përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve

“Përqëndrimet janë horizontale nëse ndërmarrjet pjesëmarrëse janë aktive në të njëjtin treg përkatës; vertikale nëse ndërmarrjet operojnë në nivele të ndryshme të tregut dhe të përziera nëse ndërmarrjet, megjithëse mund të mos jenë në nivele të ndryshme të tregut, janë aktive në tregje prodhimesh të ndryshme. Këto quhen dhe përqendrime jo-horizontale”⁴.

Bashkimet dhe përqëndrimet mund të jenë asnjëse ndaj konkurrencës ose, në disa raste, i bëjnë ndërmarrjet më efikase, forcojnë konkurrueshmërinë e tyre dhe çojnë në uljen e kostove, duke rritur përfitimet për konsumatorët. Veprimtaria e bashkimit është pjesë e ristrukturimit industrial dhe shihet si e nevojshme për t’ju përgjigjur sfidave të ekonomisë botërore. Qëllimi i rregullave të kontrollit të përqendrimeve nuk është që të pengojë ristrukturimin e nevojshëm që rrit efikasitetin, por të sigurojë që realizimi i përqendrimeve nuk është bërë për të dëmtuar konkurrencën.

Politika e kontrollit të përqendrimeve duhet të ndihmojë vendosmërisht për të nxitur zhvillimet në reformat strukturore dhe ekonomike në Shqipëri, drejt konsolidimit të

³ www.usdoj.gov/atr/public/guidelines/horiz_book/hmg1.html

⁴ P. Këllezi, “E drejta e konkurrencës”, Kurs për shkollën e lartë të magistraturës, nëntor 2004, <http://www.unige.ch/droit/ceje/documents/Kellezi.pdf>.

ekonomisë së tregut. Ky pritjet të jetë përfitimi kryesor afatgjatë nga zbatimi i rreptë i instrumenteve të politikës së konkurrencës, për të nxitur suksesin ekonomik të ndërmarrjeve dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike të vendit. Vetëm një politikë e kontrollit të përqendrimeve mund të sigurojë mbetjen e një numri të mjaftueshëm të ndërmarrjeve në treg, duke siguruar njëkohësisht një konkurrencë efektive dhe çmime të ulëta.

Eksperiencia e deritanishme e Autoritetit të Konkurrencës ka nxjerrë në pah se, në fushën e zbatimit të kuadrit ligjor dhe atij rregullator, rol të rëndësishëm po merr kontrolli i përqendrimeve të ndërmarrjeve. Nëpërmjet kontrollit të përqendrimeve, Autoriteti i Konkurrencës mund të ndalojë atë përqendrim që rrezikon të krijojë ose të forcojë pozitën dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, duke kufizuar ndjeshëm konkurrencën efektive të tregut. Në këndvështrimin e efijencës, Komisioni i Konkurrencës do të shqyrtojë me kujdes kriterin e efijencës në vlerësimin e përgjithshëm të bashkimit dhe vetë efijencën ekonomike që do të vijë nga ky bashkim, e cila duhet të tejkalojë çdo efekt negativ për konkurrencën.

Gjatë viteve të fundit, Autoriteti i Konkurrencës ka shqyrtuar disa raste të përqendrimeve, kryesisht në sektorin bankar. Në të gjitha këto raste Autoriteti ka zbatuar ligjin dhe i ka dhënë rekomandimet përkatëse Sekretariatit për ndjekjen e sjelljes në treg të ndërmarrjeve pas përqendrimeve.

Theksojmë se koncepti i përqendrimit, detyrimi për njoftim apo e gjithë procedura e kontrollit të përqendrimeve të parashikuara në ligjin 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, është e njëjtë me atë që parashikon legjislacioni evropian. Në këtë kontekst, si dhe në zbatim të detyrimit të përcaktuar në nenin 84 të ligjit, është dhe:

a) “Rregullorja për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, miratuar me vendimin nr. 80 datë 05.06.2008 të Komisionit të Konkurrencës.

b) Udhëzimi për formën e njoftimit të përqendrimit dhe Formularin për njoftimin e përqendrim të cilat u vihen në dispozicion palëve që kanë detyrimin për njoftimin e përqendrimit. Aktet nënligjore të mësipërme janë konform legjislacionit evropian për këtë qëllim.

IV.2 Instrumentet për zbatimin e politikës së konkurrencës

IV.2.1 Proçedurat hetimore

Ligji në kreun III nga neni 41 e në vijim përcakton proçedurat hetimore që ndjek Autoriteti i Konkurrencës. Shkallëzimi për të identifikuar faktorët që ndikojnë në nivelin e konkurrencës në një treg specifik realizohet nëpërmjet hetimit të përgjithshëm në këtë treg, i cili synon realizimin e një studimi tregu. Ky instrument aplikohet në ato raste kur ka shqetësime por nuk ka shenja të mjaftueshme për të adresuar problemin konkret të konkurrencës në treg.

Sipas nenit 41 mund të kryhet një hetim i përgjithshëm në një sektor të ekonomisë me nismën e tij ose nëpërmjet kërkesës së Komisionit Parlamentar të Ekonomisë, për

kryerjen e hetimeve të përgjithshme në sektorë të caktuar të ekonomisë dhe në bazë të përfundimeve të hetimit, të vendosë edhe masat përkatëse.

Në nenin 42 përcaktohen procedurat për hetimit paraprak ndërsa në nenin 43 përcaktohen procedurat për hetimin e thelluar si dhe në nenin 44 përcaktohen masat e përkohshme në rastet e urgjencës për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën.

Procedurat hetimore janë të specifikuara në aktin nënligjor miratuar me vendimin nr. 176 datë 24.2.2011 të Komisionit të Konkurrencës në rregulloren “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

Gjithashtu, krahas procedurave të përcaktuara në hetimin e një rasti, të zbatueshme janë edhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

Ligji parashikon në nenin 36 inspektimin në ndërmarrje të inspektorëve të Autoritetit me autorizim të Komisionit të Konkurrencës për të hyrë në mjediset e ndërmarrjeve, të shqyrtojë libra dhe regjistrat e veprimtarisë ekonomike, të vulosë çdo seli, libër ose regjistër etj., për jo më shumë se 72 orë, të kërkojë çdo përfaqësuesi apo punonjësi fakte dhe prova që lidhen me objektin e qëllimit të inspektimit.

Në nenin 37 parashikohet ndërhyrje në banesat e administratorëve ose mjedise të tjera me vendim nga Gjykata që ka në juridiksion vendin ku kryhet kontrolli. Sipas nenit 38 inspektorët sekuestrojnë objekte që kanë vlerën e provës material në hetim për jo më shumë se 72 orë.

Instrumenti i inspektimeve, si një instrument ligjor mundëson plotësimin e kërkesës ligjore për barrën e provës dhe grumbullimin e fakteve dhe të provave për veprimet anti-konkurrese të ndërmarrjes apo të ndërmarrjeve.

Të gjitha ndërmarrjet kanë detyrimin që t'i sigurojnë Autoritetit informacionin e kërkuar, mosdhënia e të cilit nga ndërmarrjet mund të penalizohet me gjobë deri në 1 për qind të xhiros. Ky instrument nuk është qëllim në vetvete por përbën një instrument detyrues nëse refuzohet të bashkëpunohet me Autoritetin e Konkurrencës, pasi mos marrja e informacionit e pengon këtë të fundit në realizimin e misionit të tij ligjor.

IV.2.2 Gjobat si instrument i zbatimit të politikës së konkurrencës

Një nga mjetet më kryesore në zbatueshmërinë e ligjit dhe rritjen e rolit të Autoritetit të Konkurrencës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë në treg është dhe penalizimi i ndërmarrjeve për shkeljet e ligjit.

Gjobat ndahen në dy kategori:

- a) Gjoba për shkelje të lehta, ku masa e gjobës shkon deri në 1% të xhiros totale të vitit financiar paraardhës. Këtu përfshihen të gjitha shkeljet procedurale, si refuzimi për të siguruar informacion ose dhënia e informacionit jo të saktë.
- b) Gjoba për shkelje të rënda, ku masa e gjobës shkon deri 10% të xhiros totale

të vitit financiar paraardhës. Këtu përfshihen shkeljet e ndërmarrjeve, si kufizimet horizontale nëpërmjet marrëveshjeve kartele që synojnë fiksimin e çmimeve, kuotave të prodhimit ose të shitjeve, ndarjen e tregjeve, si dhe kushte të tjera të padrejta tregtimi, reduktim të importeve ose eksporteve e praktika të tjera, të cilat vënë në rrezik vetë funksionimin e tregut. Këtu përfshihet edhe abuzimi i një pozicioni dominant (refuzimi për të furnizuar, diskriminimi, përjashtimi, ulje të ndjeshme të çmimeve), të bëra nga një ndërmarrje në pozitë dominuese, për të nxjerrë konkurrentët nga tregu.

Komisioni i Konkurrencës ka detajuar në rregulloren “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre” brenda secilës kategori dhe në veçanti, në rastin e shkeljeve të rënda, shkalla e propozuar e masës së gjobës do të bëjë të mundur trajtimin në mënyrë të ndryshme për ndërmarrjet, në përputhje me natyrën e shkeljes së kryer. Si rregull, merret parasysh:

- kapaciteti ekonomik efektiv i shkelësve për t’u shkaktuar dëmtime serioze ndërmarrjeve të tjera, në veçanti konsumatorëve, duke përcaktuar masa gjobe që sigurojnë se ato kanë efekt të mjaftueshëm.
- fakti që ndërmarrjet e mëdha zakonisht kanë mundësi ekonomike e ligjore dhe infrastrukturë të tillë, që i bën të afta të kuptojnë nëse sjellja e tyre përbën një shkelje të ligjit, si dhe të jenë në dijeni të pasojave që rrjedhin nga kjo.

Masa e gjobës gjykohet rast pas rasti, sipas rëndësisë dhe kohëzgjatjes së shkeljes. Gjithashtu, Autoriteti zbaton edhe vendosjen e gjobave progresive, të cilat mund të arrijnë deri në 5% të xhiros mesatare ditore të vitit paraardhës financiar, kur ndërmarrjet nuk ekzekutojnë vendimin brenda afateve të caktuara në vendimin e dhënë nga Autoriteti. Vendosja e gjobave të tilla është e nevojshme, sidomos në ekzekutimin e vendimeve për marrjen e masave të përkohshme apo të vendimeve që miratojnë angazhimet e ndërmarrjeve.

IV.2.3 Programi për lehtësimin nga gjobat

Programi i lehtësimeve është një kuadër i përgjithshëm për reduktimin e plotë ose të pjesshëm të gjobave të vëna për ndërmarrjet, të cilat bashkëveprojnë me Autoritetin e Konkurrencës në hetimet e marrëveshjeve të ndaluara. Lehtësimet përfshijnë marrëveshjet e fshehta ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve, që synojnë fiksimin e çmimeve, të prodhimit apo të kuotave të shitjeve, ndarjen e tregjeve, duke përfshirë edhe tenderimet e parregullta apo kufizimin e importeve dhe të eksporteve. Zbulimi i këtyre marrëveshjeve i shërben interesit të përgjithshëm publik dhe, në mënyrë të veçantë, konsumatorëve, mbasi vetëm konkurrenca mund t’u shërbejë këtyre të fundit.

Ndërmarrjet e përfshira në këto lloj marrëveshjesh mund t’i japin fund pjesëmarrjes së tyre dhe të mënjanojnë gjobën, pjesërisht ose plotësisht duke ofruar provat lidhur me çështjen në investigim. Si pjesë të politikës së tij, Autoriteti i Konkurrencës ka hartuar edhe Programin e Ri të Lehtësimit nga Gjobat e cila pas diskutimit me palët e interesit do të miratohet nga Komisioni i Konkurrencës.

V. POLITIKA E KONKURRENCËS DHE DERREGULLIMI SEKTORIAL

Qëllimi i politikës së konkurrencës është mirëfunksionimi i tregut në tërësi. Politika e konkurrencës përfshin përcaktimin e sektorëve, zhvillimi i të cilëve frenohet nga mungesa e konkurrencës dhe për rrjedhojë, nuk mund të kenë efikasitet.

Duke vlerësuar nevojën për treg të hapur dhe konkurrencë të lirë, heqjen apo zvogëlimin e pengesave tekniko-administrative të hyrjes, krijimin e një tregu atraktiv për investimet e huaja, konsolidimin e partneritetit të shtetit me privatën nëpërmjet zbatimit të projekteve të përbashkëta, pjesëmarrjes së publikut në proceset e privatizimit dhe për t'i bërë ato sa më transparente, duhet të studiohet tregu aktual, forcat që veprojnë në të, prirjet e tij, shkalla e respektimit të rregullave të lojës, me synim marrjen e masave të nevojshme për rregullimin *ex-ante* dhe kontrollin e tij *ex-post*.

Studimi i tregut kalon nëpërmjet dy fazave:

a) Identifikimi i tregut

Vlerësimi i thjeshtë i konkurrencës (përcaktimi i tregut **përkatës**; përmbledhja e karakteristikave për çdo treg; përfshirja e një pasqyre të qartë rreth efekteve pozitive dhe negative në zgjedhjet e çdo politike konkurrence, të shoqëruara me shpjegime të argumentuara).

b) Vlerësimi i konkurrencës

Vlerësimi i hollësishëm i konkurrencës përfshin përcaktimin e tregut të prekur nga rregullimi, pa lënë jashtë këtij përcaktimi tregun e prekur në mënyrë të **tërthortë**; kuptimin e natyrës së konkurrencës në tregjet përkatëse kur shfrytëzojmë në mënyrë më të hollësishme faktorët, si nga ana e kërkesës ashtu dhe nga ajo e ofertës, prodhimet e tregut dhe proceset konkurruese dhe përcaktimi i ndikimit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konkurrencë që del nga çdo zgjedhje e politikës në procesin e vlerësimit rregullues.

V.1 Bashkëndimi i politikës së konkurrencës me politikat publike në sektorët e rregulluar

Ligji për mbrojtjen e konkurrencës nuk parashikon asnjë përjashtim për sektorët e rregulluar. Ky ligj zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë sektorët e ekonomisë, gjë që mënjanon shtrembërimet e konkurrencës nga njëri sektor në tjetrin. Bashkëndimi i zbatimit të ligjeve vihet në jetë duke zbatuar disa parime të thjeshta dhe nëpërmjet formalizimit të bashkëpunimit ndërmjet enteve rregullatorë, qeverisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Në sektorët e rregulluar ose në liberalizim e sipër, politika e konkurrencës ka të njëjtin qëllim me legjislacionin e posaçëm. Ndërsa ky i fundit ka për qëllim hapjen e tregut nën kushte të caktuara, duke përdorur mekanizmin e kontrollit paraprak, ligji për konkurrencën ka për qëllim mbrojtjen e konkurrencës me anë të kontrollit të sjelljes *ex post*. Procesi i liberalizimit kryhet në mënyrë progresive, sa më shumë të hapet

tregu dhe sa më shumë konkurrencë të ketë në treg, aq më pak ka nevojë për rregulla të veçanta të kontrollit paraprak. Nga kjo pikëpamje, liberalizimi progresiv i tregjeve do të bëjë të mundur kalimin nga zbatimi i një legjislacioni të posaçëm tek zbatimi i vetëm i rregullave të përgjithshme për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, në fazën fillestare të liberalizimit të tregjeve në të cilën ndodhet Shqipëria, zbatimi i legjislacionit sektorial do të ketë një rol kryesor dhe në të ardhmen e afërt.

Kur ligjet e sektorit përkatës parashikojnë marrjen e masave të posaçme, si kontrolli i çmimeve ose aksesit në infrastruktura fizike, entet rregullatorë sektoriale kanë detyrën dhe përgjegjësinë kryesore për të mbikëqyrur këta parametra të konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës mund të ndërhyjë kur entet rregullatorë sektoriale nuk mund ose nuk veprojnë në kohën e duhur për të zgjidhur problemet, gjithmonë brenda kompetencave që i njeh ligji për konkurrencën dhe burimeve financiare të vëna në dispozicion.

Në sektorët e rregulluar, zbatimi i ligjit të konkurrencës varet nga shkalla e konkurrencës që lejohet në treg. Në parim, nëse ligjet përkatëse fiksojnë parametrat kryesorë të konkurrencës, si çmimin dhe sasinë, duke mos lënë më vend për konkurrencën, ligji për mbrojtjen e konkurrencës nuk do të zbatohet, për arsye se legjislatori ka vendosur që mbrojtja e interesave të tjera publike justifikon uljen e shkallës së konkurrencës.

Për të mënjanuar zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës është e nevojshme që legjislacioni përkatës të shmangë tërësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë konkurrencën. Për shembull, çmimi nuk quhet i fiksuar kur legjislacioni përkatës përcakton vetëm mënyrën e llogaritjes së tij apo të kostos, ose kur legjislacioni përkatës vendos një çmim tavan. Në mënyrë të ngjashme, çmimi nuk quhet i fiksuar nga ligji nëse ndërmarrjet janë të lira të përcaktojnë qoftë dhe një pjesë të vogël të tij. Në këto raste, konkurrenca ndërmjet operatorëve ndikon në çmimin e tregut, dhe sjelljet e tyre janë subjekt i ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Për të mënjanuar zbatimin e ligjit për konkurrencën, fiksimi i çmimeve ose i parametrave të tjerë të konkurrencës duhet të parashikohet në mënyrë të qartë në një ligj formal të votuar nga Kuvendi i Shqipërisë, ose në një akt nënligjor, i cili bazohet në një delegim të qartë të kompetencës të parashikuar në ligjin formal. Kjo përputhet me parimin sipas të cilit, mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive, e parashikuar në ligjin për konkurrencën dhe dispozitat materiale të tij, nuk mund të anashkalohej, përveç rasteve kur një gjë e tillë përcaktohet qartë në akte normative të të njëjtit nivel kushtetues. Nëse interpretimi i ligjit formal nuk nxjerr në pah në mënyrë të qartë kompetencën e një autoriteti për të vendosur një çmim fiks, Autoriteti i Konkurrencës zotëron kompetencë të plotë për të ndërhyrë në treg.

Kur çmimi përcaktohet në akte nënligjore ose në vendime të përgjithshme (ose individuale) të autoriteteve qendrore, por pa pasur një delegim kompetencash të qarta nga ligji formal, ndërhyrja e këtyre autoriteteve mund të konsiderohet pa pasoja juridike, ligji për mbrojtjen e konkurrencës mund të zbatohet plotësisht. Siç parashikohet në nenin 118 të Kushtetutës së Shqipërisë, pika 1 dhe 2, aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet, në bazë të të cilave nxirren këto akte. Gjithashtu, ligji formal që rregullon një

sektor të caktuar duhet të parashikojë organin kompetent, të shprehë qartë që ky i fundit zotëron një kompetencë për caktimin ose miratimin e çmimeve, si dhe rastet në të cilat caktohet çmimi. Gjithashtu, përcaktohet se ky organ duhet të ushtrojë kompetencën, domethënë duhet të ketë marrë një vendim për rastin konkret.

Kur një ligj formal i njeh kompetencën një autoriteti për fiksimin ose miratimin e një çmimi, Autoriteti i Konkurrencës, në parim, nuk mund të ndërhyjë me anë të vendimmarrjes së tij, për arsye se ligji në fjalë, i votuar në mënyrë demokratike nga Kuvendi i Shqipërisë, ia jep këtë kompetencë autoritetit përkatës. Autoriteti i Konkurrencës mund t'i drejtojë autoritetit kompetent për zbatimin e ligjit një rekomandim, nëse masat e marra prej tij (për shembull niveli i çmimit) nuk janë në përpjesëtim me objektivin e ndjekur. Në këtë kontekst, veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës do të përqendrohet në avokatinë e konkurrencës ndaj autoriteteve të tjera publike.

V.2. Konkurrenca në tregjet e rregulluara

V.2.1 Sektori i Komunikimeve Elektronike

Sektori i Komunikimeve Elektronike ka njohur zhvillime të rëndësishme në vitet e fundit si pasojë e hyrjes së teknologjive të reja në shërbimet e telefonisë dhe të internetit, por edhe rritjes së konkurrencës mbi bazën e vendimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës. Konkurrenca dhe rregullimi janë integruar të njëri-tjetri për të ulur fuqinë e operatorëve dhe treguesit e përqendrimit të tregjeve.

Komisioni Evropian i ka dhënë një rol të rëndësishëm Autoritetit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Rregullatorit, me qëllim nxitjen dhe garantimin e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike. Në zbatim të legjisllacionit për mbrojtjen e konkurrencës, Komisioni Evropian thekson gjithashtu se autoritetet vendase duhet të vlerësojnë nëse konkurrenca është “efektive” duke nënvizuar faktin se konkurrenca efektive ekziston nëse “nuk ka operatorë që gëzojnë një pozitë dominuese në treg qoftë më vete apo bashkërisht”.

Bazuar në Ligjin Nr. 9918, AKEP-i duhet të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës dhe AKEP kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me datë 29.08.2007, ku midis të tjerave “Neni 6”, parashikon bashkëpunimin midis dy autoriteteve për përcaktimin e tregut, përcaktimin e dominancës / përcaktimi i FNT.

Autoriteti i Konkurrencës ka ndërmarrë monitorime, hetime dhe ka dhënë rekomandime për të rritur konkurrencën në sektorin e Komunikimeve Elektronike në përgjithësi, dhe në mënyrë të veçantë në tregun e telefonisë së lëvizshme, si dhe në lidhje me liberalizimin e tregut nëpërmjet hyrjes në treg të Eagle Mobile dhe operatorit të katërt celular PLUS, aplikimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave dhe implementimin e portabilitetit të numrit, reduktimit të tarifave të terminimit, ndryshime ligjore për përshtatjen e Ligjit me direktivat e KE-së, etj.

Me vendimin nr. 59, datë 09.11.2007, Komisioni i Konkurrencës ka provuar se shoqëritë AMC dhe Vodafone kanë abuzuar me pozitën dominuese duke vendosur çmime të padrejta në tregun e telefonisë së lëvizshme gjatë periudhës objekt-hetimi (2004-2005). Për shkeljet e konstatuara shoqëritë AMC dhe Vodafone janë gjobitur me 2 % të xhiros vjetore, respektivisht 211 552 000 lekë dhe 242 633 000 lekë.

Kompanitë e ankimuan vendimin në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë veç e veç. Në vendimin për pjesën e AMC-së, gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 172 të datës 19 janar 2009 ka mbështetur konkluzionin e Komisionit të Konkurrencës. Sipas vendimit të Gjykatës, tarifat e shërbimit të telefonisë celulare në Shqipëri të krahasuara me tregjet e tjera gjeografike janë tepër të larta. Duke patur në konsideratë sa është analizuar për vërtetimin e testeve të përcaktuara nga BE, gjykata arrin në përfundimin se AMC ka abuzuar me pozitën e saj dominuese në treg. Për rrjedhojë konkludon Gjykata, Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 59, datë 09.11.2007 është i drejtë, i bazuar në ligj dhe në prova dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi. Edhe Gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndërkohë që pritet që çështja të shqyrtohet nga ana e Gjykatës së Lartë pas rekursit të AMC-së.

Mbështetur në këtë hetim në tregun e telefonisë së lëvizshme Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 61 datë 21.11.2007, dha disa rekomandime Këshillit të Ministrave dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve mbi liberalizimin e tregut të telefonisë së lëvizshme, nëpërmjet hyrjes në treg të operatorit të tretë, "Eagle Mobile" brenda afatit ligjor të parashikuar në kriteret e licencës dhe hapjen e procedurave për një licencë të katërt në tregun e Telefonisë së Lëvizshme. Në këtë vendim i është rekomanduar ERT-së që dispozitat mbi Operatorët me Fuqi të Ndjeshme në Treg në ligjin nr. 8618, datë 14.06.2000 "Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë" të përshtaten me Strukturën Rregullatore për Komunikimet Elektronike të BE-së, sidomos me Direktivat e Vitit 2002. Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës është shprehur mbi domosdoshmërinë e hartimit të Metodologjisë së Rregullimit të Tarifave të përdoruesve dhe të interkonjeksionit të dy operatorëve celularë, të shpallur OFNT, dhe mbi rritjen e transparencës dhe respektimin e parimit e mos-diskriminimit mes operatorëve të tregut të telefonisë për marrëveshjet e interkonjeksionit. Gjithashtu, i është rekomanduar Entit Rregullator të Telekomunikacioneve që duhet të ndërhyjë që marrëveshjet për interkonjeksionit të mos çenojnë parimet e konkurrencës në tregun e telekomunikacioneve. Institucionet e mësipërme i janë përgjigjur rekomandimeve duke hartuar dhe publikuar rregulloret përkatëse.

Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr.258 , datë 21.12.2012, pas ankesave të operatorëve vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes objekt hetimi rezultoi se strategjia e ndjekur nga operatori Vodafone Albania shkakton shqetësime për konkurrencën në tregun përkatës si dhe efekte negative për konkurrencën në periudha afatgjata ndaj konkurrentëve më të vegjël, nëpërmjet aplikimit të diferencimit të çmimit të thirrjeve brenda me jashtë rrjetit (*on-net vs off-net*). Ndërmarrja Vodafone është angazhuar publikisht që të barazojë tarifat brenda Vodafone Club dhe jashtë rrjetit të Vodafone (drejt nr. fiks, AMC, Eagle dhe Plus) për të ulur drejt eliminimit diferencimin e tarifave të thirrjeve brenda me jashtë rrjetit.

Me Vendimin nr. 303 datë 16.01.2014, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, të marrë masat e ndërmjetme dhe të menjëhershme, përpara përfundimit të analizës së tregut të pakicës së telefonisë celulare, për të bërë të zbatueshme zgjidhjet e rregullimit të tregut për të parandaluar daljet nga tregu që do kishin pasoja afatgjatë mbi konkurrencën, dhe në veçanti të modifikojë modelin BULRAIC duke ulur ndjeshëm koston e terminimit për operatorët e vegjël ndaj operatorëve të mëdhenj në këtë treg, me qëllim nxitjen e

konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun përkatës, të detyrojë zvogëlimin real të diferencës së tarifave *off-net/on-net* brenda dhe jashtë paketave dhe planeve tarifore specifike për operatorët që kanë pozitë dominuese; të realizojë analizën e tregut të pakicës në telefoninë celulare për të adresuar zgjidhjet për shqetësimet e konkurrencës në tregun e telefonisë celulare me pakicë, duke ndërmarrë masa konkrete rregullatore për reduktimin e diferencimit të theksuar të tarifave për thirrjet brenda rrjetit me tarifat jashtë rrjetit të operatorit Vodafone. Në rolin e rregullatorit të monitorojë zbatimin e angazhimit publik të Vodafone Albania për barazimin e tarifave brenda Vodafone Club dhe jashtë rrjetit të Vodafone (drejt fix, AMC, Eagle dhe Plus) dhe në veçanti, reflektimin e zvogëlimit real të kësaj difference jo vetëm në tarifat nominale (*off-net, on-net*), por edhe në njësitë e përfshira në paketat opsionale të komunikimit kombëtar (ofertat dhe paketat javore, mujore e vjetore).

Rekomandimet e dhëna janë marrë në konsideratë nga ana e AKEP në analizën e tregut të telefonisë celulare. Autoriteti Konkurrencës ka kërkuar nga AKEP statusin e zbatimit të vendimeve për rregullimin e tregut.

Gjatë vitit 2014, pas një ankese të një konkurrenti, ndaj Vodafone Albania Sh.a. për sjellje abuzive në shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" gjatë periudhës 01.01.2013-31.12.2013 dhe pasojat serioze që lindin nga ky abuzim në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme në Shqipëri, Komisioni Konkurrencës ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare ndaj shoqërisë Vodafone, për të vlerësuar nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës, sipas parashikimeve të nenit 9 të ligjit Nr. 9121, "Për Mbrojtjen e Konkurrencës".

Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit Nr. 366, datë 04.06.2015, "Për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit", vendosi: - Detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e vendimit 356 të Komisionit të Konkurrencës të datës 31.03.2015 për marrjen e masave detyruese që të ndalojë të aplikojë tarifa në nivel pakice që kanë efekt diskriminues për sipërmarrësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare, për të gjitha ofertat e hedhura në treg; - Barazimi i tarifave brenda me jashtë rrjetit ("*on net*" dhe "*of net*") do të jetë për të gjitha ofertat, opsionet dhe tarifat e thirrjeve standarde për të gjitha paketat dhe shërbimet e telefonisë celulare të shoqërisë Vodafone Albania Sh.a; - Sasia e minutave brenda rrjetit të përfshira në ofertat/pagesë fikse të paketave tarifore nuk mund të jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare; - Gjatë procesit të ndryshimit të planeve tarifore dhe ofertave të njoftojë abonentët mbi ndryshimet në planet tarifore të thirrjeve standarde dhe ofertave; - Moszbatimi i vendimit ndëshkohet me gjobë për shkelje të rënda deri në 10 % të xhiros së vitit financiar paraardhës, sipas parashikimeve të nenit 74, pika 1 germa b të ligjit Nr. 9121 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" i ndryshuar.

Autoriteti i Konkurrencës është shprehur gjithashtu në lidhje me brezat e frekuencave me Vendimin nr. 161 datë 02.12.2010 për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë '3G', për ti vënë në kushte të barabarta teknike dhe konkurrencë të gjithë operatorët celularë.

Autoriteti i konkurrencës ka shqyrtuar dhe ka dhënë rekomandime për dokumentin e

AKEP “Analiza e Tregut Celular: Tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë i shërbimeve publike celulare”. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 124, datë 23. 09. 2009 i rekomandoi AKEP: - Aplikimin e metodologjisë së rregullimit të tarifave jo vetëm për shërbimin me parapagesë por edhe për shërbimin me kontrate, mesazhet elektronike (sms) dhe shërbime të tjera; - Aplikimin e “Metodologjisë së Rregullimit të Tarifave të Terminimit” derisa tarifat e telefonisë celulare të jenë të krahasueshme me mesataren e tarifave që aplikohen në vendet e Bashkimit Evropian; - Dhënien e licencës së re, në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme, ta shoqërojë me marrjen e të gjitha masave të nevojshme për ta bërë sa më shpejt efektiv operatorin e katërt me synim rritjen e konkurrencës në treg.

Në tregun e shërbimeve të internetit dhe të telefonisë fikse, gjatë vitit 2013, është realizuar një përqëndrim nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria “AD-Trade” të shoqërisë ‘Primo Communications’ sh.p.k. nëpërmjet përfutimit të 100% të kuotave të saj nga Telekom Slovenia. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr.294, datë 28.10.2013, vendosi të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit.

Në këtë treg është realizuar hetimi paraprak në tregun e ofrimit të kartave me parapagesë. Pas shqyrtimit të ankesës së një operatori, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 204, të datës 14.11.2011, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 231, datë 05.07.2012 dha rekomandime ndaj Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë”, që: - Të vendosë detyrimin për ndërmarrjen Albtelekom që gjithë shërbimet apo produktet që ALBTELEKOM ofron për konsumatorin të pasqyrohen apo të mbahen në llogari financiare të veçanta, duke përfshirë edhe kartën më parapagesë në telefoninë fikse ALBLUE.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimit Nr. 210, dt. 21.12.2011, bazuar në ndikimin në konkurrencë të bashkimit mes Albtelecom Sh.a dhe “Eagle Mobile”, i ka rekomanduar AKEP, që në autorizim të kërkojë nga shoqëria e përfutuar, ndarjen e llogarive për telefoninë fikse dhe atë të lëvizshme duke mundësuar verifikimin e burimit të gjenerimit të të ardhurave për të siguruar mos-diskriminimin ndaj operatorëve konkurrentë të Eagle Mobile në telefoninë e lëvizshme, prej OFNT në telefoninë fikse Albtelecom.

Vlerësimi i raportit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare “Analiza e tregut të telefonisë fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjete fikse; Konsultim publik”, për të cilën Komisioni i Konkurrencës është shprehur me Vendimin Nr. 130 datë 23. 11. 2009 për disa rekomandime. Këto rekomandime konsistojnë në aplikimin e metodologjive respektive derisa tarifat e shërbimeve të jenë të krahasueshme me ato të vendeve të rajonit dhe të Bashkimit Evropian si dhe orientimin e tarifave drejt kostove.

Autoriteti i Konkurrencës ka Shqyrtuar dokumentin e AKEP “Analizë e tregut të telefonisë fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjete fikse”. Si rezultat Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 130, dt. 23.11.2009 vendosi

ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare(AKEP): 1. Të vazhdojë aplikimin e “Metodologjisë së rregullimit të tarifave” derisa tarifa e thirrjeve kombëtare të jetë e krahasueshme (benchmark) me mesataren e tarifave që aplikohen në vendet rajonit dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian; 2. Rregullimin e plotë të tarifave të aplikuara nga Albtelekom duke rritur tarifat që janë nën kosto dhe duke rritur tarifat që janë mbi mesataren e vendeve të rajonit duke i orientuar drejt kostos në mënyrë që të mundësohet një konkurrencë efektive mes operatorëve; 3. Pas vlerësimit të kostove të Albtelekom në modelin BULRAIC, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare duhet të balancojë tarifat e Albtelekom dhe t’i orientojë drejt kostos.

Ndërhyrja e Autoritetit të Konkurrencës në tregun e telefonisë fikse gjatë vitit 2007 pati zhvillime të rëndësishme në sektorin e telekomunikacioneve. Shitja e paketës prej 70 për qind të aksioneve të kompanisë publike “Albtelekom” dhe ndryshimi i pronarit të operatorit të tretë të telefonisë celulare “Eagle Mobile” krijoi mundësi për investime të reja në këtë treg. Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në tregun e telefonisë gjatë vitit 2007 ishte liberalizimi i telefonisë fikse edhe në zonat urbane. Si pasojë e këtij liberalizimi shumë operatorë alternativ që ofronin shërbimin e tyre vetëm në zonat rurale kanë aplikuar për një ndryshim të licencave të tyre duke kërkuar që të ofrojnë shërbimet edhe në zonat urbane.

V.2.2 Sektori energjetik

V.2.2.1 Tregu i Energjisë elektrike

Tregu i energjisë elektrike karakterizohet nga dominanca në pjesën më të madhe apo në të gjitha nivelet e tij. Modeli aktual i tregut të energjisë elektrike përbëhet nga pesë segmente tregu që janë:

1. Tregu i gjenerimit të energjisë elektrike
2. Tregu i furnizimit me shumicë
3. Tregu i transmetimit të energjisë elektrike
4. Tregu i shpërndarjes së energjisë elektrike
5. Tregu i furnizimit me pakicë

Tregu i gjenerimit dhe tregu i furnizimit me shumicë janë ndërmarrje vertikalisht të integruara (KESH SH.A) dhe kryejnë funksionet e gjenerimit të energjisë elektrike dhe të furnizimit publik me shumicë. Secila nga këto ndërmarrje ka pozicion monopol në tregun përkatës.

Duke marrë parasysh edhe fuqinë e përgjithshme të instaluar të prodhuesve privat të energjisë elektrike prej 375 MW, fuqia e përgjithshme e instaluar në vendin tonë rezulton 1 823 MW. Prodhimi publik i energjisë elektrike në vitin 2014 u realizua 100% nga centralet hidroelektrike (HEC-et). Prodhimi neto prej 4,724,430 MWh u realizua 3,406,226 MWh nga centralet prodhuese hidro të KESH Sh.a (prodhimi publik) dhe 1,318,204 MWh nga hidrocentralet e tjerë.

Gjatë vitit 2014 kanë prodhuar energji elektrike 98 centrale hidrike private apo me konçesion. Nga këto 93 prej tyre kanë pasur kontratë shitje me KESH, një është prodhues i shkëputur nga prodhimi publik por me kontratë shitje me FPSH kurse 4 të tjera kanë prodhuar për nevojat e veta apo për tu tregtuar.

Tregu i transmetimit përfaqësohet nga një ndërmarrje që kryen funksionin e transmetimit dhe të dispecerimit të energjisë elektrike. Tregu i transmetimit është me pozicion monopol natyror në shërbimin e transmetimit.

Tregu i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Furnizuesi Publik me Pakicë janë dy segmente tregu të integruara vertikalisht që i përkasin OSHEE Sh.a.(ish OSSH Sh.a). Gjithashtu edhe këto janë ndërmarrje me pozicion monopol në tregun përkatës. Të gjitha funksionet në gjenerim, furnizim me shumicë, transmetim, shpërndarje dhe furnizim me pakicë, në përgjithësi i rregullojnë marrëdhëniet nëpërmjet kontratave të rregulluara dypalëshe.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, së bashku me dy segmentet e tij shpërndarjen e energjisë dhe furnizimin publik me pakicë, u privatizua në 11 Mars 2009, dhe 76% të aksioneve kontrollin e pronësisë e mori kompania shtetërore Çeke, Cez A.S. Ndërsa në Korrik 2014 u zgjidh me mirëkuptim problemi i kontrollit të pronësisë mbi aksionet e CEZ Shpërndarje Sh.a. ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ, A. S. Sipas kësaj marrëveshjeje aksionet e CEZ Shpërndarje Sh.a. i kaluan në pronësi shtetit shqiptar. Aktualisht shteti shqiptar zotëron 100 % të aksioneve të kësaj kompanie.

Tregu aktual i energjisë elektrike rregullohet me aktet nënligjore kryesore që rregullojnë veprimtarinë e tregut të energjisë elektrike që janë Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 338, dt. 19.03.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, dhe Deklarata Rregullatore e miratuar nga ERE. Këto akte nënligjore i përkasin ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Por me miratimin e ligjit të ri 43/2015 datë 30.04.2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, i cili është hartuar në përputhje me deklaratën e tretë rregullatore, pritet të ndryshojnë edhe aktet nënligjore në zbatim të tij, dhe modeli i tregut.

Ligji i ri do i hapë rrugën liberalizimit të tregut, parashikon furnizimin e shkëputur nga tregu i gjenerimit dhe tregu i shpërndarjes, si dhe do të krijojë më shumë mundësi zgjedhjeje për konsumatorin përfundimtar.

Me miratimin dhe aplikimin e ligjit të ri pritet të gjejnë zgjidhje problemet dhe inefiçencat që kanë shoqëruar këtë modelin aktual të tregut dhe që përfshijnë: - çmimet e pabazuara në kosto; - cilësia e dobët e shërbimit; - vështirësia për të financuar investime të reja; - prodhimtaria e ulët; - konkurrencë efektive në tregun e furnizimit me energji elektrike, dhe në nivelet e tjera të tregut.

Modeli i ri i tregut pritet të performoje si një treg që do të krijojë mundësi zgjedhjeje për konsumatorët e një tregu që do të drejtohet nga rregulla të qarta, transparente dhe jo diskriminuese, ku pjesëmarrësit e tij privatë janë pronarë dhe që do të operojnë dhe konkurrojnë në segmentet gjeneruese, transmetuese dhe shpërndarëse të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

Autoriteti i Konkurrencës, në kuadër të bashkëpunimit me ERE-n, ka dhënë opinione dhe rekomandime të ndryshme, për konkurrencë efektive në tregun e energjisë elektrike.

V.2.2.2 Tregu i Gazit Natyror

Tregu i gazit natyror ka patur zhvillime të rëndësishme, kështu në kuadër të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik Pipeline-TAP, janë hartuar dhe miratuar disa akte rregullatore të bashkërenduara me fqinjët Greqi dhe Itali.

Projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) është pjesë e sistemit të transmetimit të gazit të prodhuar nga vendburimi Shah Deniz 2 (SD 2) në Azerbajxhan drejt Tregut Evropian të Gazit. Projekti është parashikuar fillimisht të transportoje 10 bcm/vit, me mundësinë për zgjerimin më vonë të kapacitetit deri në 20 bcm/vit nëpërmjet shtimit të stacioneve të reja të kompresorëve.

Tregu shqiptar i gazit natyror është një treg i brishtë, ose pothuajse in-ekzistent. Kështu duhet një studim i kapaciteteve dhe mundësive reale, të biznesit për shfrytëzimin me efikasitet të mundësive për të përdorur burimet e TAP, me qëllim që të ndihmojë në zhvillimin real të tregut të gazit natyror, me qëllim përdorimin e tij si mundësi alternative energjie.

E konsiderojmë shumë të rëndësishme që në kuadër të angazhimit të projektit TAP-AG si pjesë e procedurave të First Booking Phase, që TAP-AG të vazhdojë të diskutojë me MEI për procedurat e mëtejshme që rrjedhin nga marrëveshja (*Host Government Agreement*), për të realizuar një bashkëpunim të suksesshëm ndërmjet ERE dhe MEI, me qëllim përfitimin maksimal për zhvillimin e tregut shqiptar të gazit.

Në mbështetje të zhvillimit të tregut të gazit natyror dhe të projektit TAP, u miratua ligji i ri "Për sektorin e gazit", mbështetur në direktivat e BE për gazin, i cili pritet të krijojë hapësirat dhe kushtet për zhvillimin e një tregu real, eficient, tërheqës dhe konkurrues të gazit në Shqipëri. Pas miratimit të ligjit do të hartohen edhe aktet nënligjore si modeli i tregut, i cili do të përcaktojë qartë rolin, detyrat dhe funksionin e secilit operator të tregut.

Autoriteti i Konkurrencës në kuadër të bashkëpunimit me ERE-n, ka dhënë opinione dhe rekomandime në kuadër të projektit TAP, që në fazën e parë të diskutimit për miratim dhe në fazat e mëvonshme gjatë miratimit të rregulloreve të përbashkëta. Synimi ynë është të kontribuojmë për të ndërtuar një treg sa më eficient, të përafuar me legjislacionin e BE-së, ku të ketë një konkurrencë efektive me qëllim përfitimin e konsumatorëve përfundimtar. Gjithashtu, në këtë kuadër kemi bashkëpunuar duke dhënë opinionet rreth projekt-ligjit "Për sektorin e Gazit Natyror".

V.2.3 Sektori financiar

Mbikëqyrja e tregut financiar ka për qëllim, ndër të tjera, sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit financiar, krijimin e një tregu financiar eficient, mbarëvajtjen e shoqërive financiare dhe të bankave, si dhe mbrojtjen e depozituesve. Kompetencat e autoriteteve mbikëqyrëse (e Bankës së Shqipërisë ose e Autoritetit Mbikëqyrës Financiar) përkohë me këtë mision: ato kanë si detyrë kryesore liçensimin e subjekteve dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë financiare të tyre.

Ky mision, megjithëse nuk bie ndesh me atë të Autoritetit të Konkurrencës, është i ndryshëm nga misioni i këtij të fundit. Detyra e Autoritetit të Konkurrencës është mbrojtja e konkurrencës në tregun financiar me anë të ndalimit të marrëveshjeve që kufizojnë konkurrencën ndërmjet subjekteve të licensuara, ndalimit të abuzimit të pozitës dominuese dhe kontrollit paraprak të përqëndrimeve.

Autoriteti i Konkurrencës që nga fundi i vitit 2009 dhe gjatë vitit–2010, ka kryer një monitorim të tregut të shërbimeve bankare me qëllim vlerësimin e sjelljes së bankave të nivelit të dytë në lidhje me transparencën për klientët si dhe krahasimin e tarifave të shërbimeve bankare në Shqipëri me bankat homologe në rajon. Metodologjia e zbatuar është e ngjashme me atë të Komisionit Evropian për monitorimin e tregut të shërbimeve bankare dhe ka si qëllim matjen e nivelit të transparencës së kushteve të punës në banka.

Monitorimi në tregun e shërbimeve bankare u ndërmor nga ana e Autoritetit të Konkurrencës për shkak të shqetësimit publik të komunitetit të biznesit dhe klientëve individë për rritjen e komisioneve të shërbimeve bankare dhe mungesën e transparencës nga ana e bankave. Transparenca e shërbimeve bankare dhe tarifave përkatëse është faktor i rëndësishëm për zgjedhjen konsumatore dhe si rrjedhojë për konkurrencën e lirë dhe efektive në tregun bankar, të cilat janë objekt i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Pas monitorimit Komisioni i Konkurrencës me vendimin 174/2011 vendosi t'i rekomandojë Bankës së Shqipërisë:

a. Të përmirësojë instrumentet për të forcuar zbatimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për transparencën e bankave të nivelit të dytë, në mënyrë të veçantë në rastet kur bankat rrisin në mënyrë të njëanshme dhe pa njoftuar tarifat e shërbimeve për klientët.

b. Të marrë masa për rritjen e transparencës së bankave të nivelit të dytë për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare nëpërmjet vendosjes së detyrimit për krijimin dhe përditësimin e informacionit në faqet e internetit të bankave të nivelit të dytë në lidhje me publikimin e kushteve të punës.

Rritja e transparencës do t'ju ofronte më shumë mundësi zgjedhje klientëve duke rritur në këtë mënyrë konkurrencën midis bankave.

Gjithashtu, vendosi t'i rekomandojë Komisionit të Mbrojtjes Konsumatore propozimin e nismës ligjore për ngritjen e një strukture të veçantë (Ombdusman) për mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet e mundshme të sistemit bankar. Ombdusmani për klientët e bankave duhet të ngrihet si një autoritet publik në shqyrtimin e ankesave të klientëve në lidhje me produkte të ndryshme të ofruara nga bankat e nivelit të dytë.

Me nismën e tij, gjatë vitit 2008 nisi një monitorim në tregun bankar në përgjithësi dhe tregun e bonove të thesarit në veçanti, për të parë nëse konkurrenca në këtë treg ishte e kufizuar si pasojë e sjelljes së një apo disa aktorëve të tregut apo si pasojë e akteve ligjore/nënligjore që rregullonin këtë treg.

Pas monitorimit procesi kaloi në fazat e hetimit paraprak dhe më pas hetimit të thelluar me hipotezën nëse banka me pozitë dominuese Raiffeisen Bank SHA kishte abuzuar në tregun përkatës të bonove të thesarit.

Në konkluzion, Komisioni i Konkurrencës vendosi mbylljen e hetimit të thelluar ndaj

Raiffeisen Bank SHA për abuzim me pozitën dominuese në tregun primar dhe sekondar të bonove të thesarit dhe vendosjen e kushteve dhe detyrimeve ndaj Raiffeisen Bank SHA mbi bazën e angazhimeve të shprehura nga banka në seancën dëgjimore.

Këto angazhime kishin të bënin me:

- I. Uljen e komisioneve që i tarifohen individëve në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në tregun primar. Këto komisione duhet të ulen në masën 50%, për një periudhë 3 vjeçare, me qëllim që të nxitet dhe të rritet pjesëmarrja e individëve në tregun primar.
- II. Korrigjimet për të përmirësuar dhënien e informacionit mbi BTH tek publiku si më poshtë:
 - a. RB do të hartojë *ad hoc* material mbi marketingun që do të ekspozohet dhe/ose shpërndahet në secilën prej degëve të saj.
 - b. Në çdo degë do të shfaqen në mënyrën e duhur tendencat e yield-it të BTH të përditësuara në kohë.
 - c. Informacioni rreth BTH do të jetë i publikuar në faqen e internetit të RB nëpërmjet një linku të identifikueshëm.

V.2.4 Tregu i sigurimeve

Gjatë 10 viteve të fundit tregu i sigurimeve ka qenë nën procedurë hetimore të vazhdueshme për problematikën e shfaqur sa i përket kryesisht produkteve të sigurimeve të detyrueshme të mjeteve motorike.

Që me vendimin nr. 28 të datës 23.12.2005 Komisioni i Konkurrencës ka dhënë rekomandime për funksionimin e tregut duke kërkuar nga Byroja e Sigurimeve dhe Ministria e Financave ndalimin e tregimit të *pool* të sigurimit kufitar me të njëjtën tarifë dhe ndarjen e tregut.

Me vendim nr. 50 dt. 21.3.2007 Komisioni i Konkurrencës ka vendosur gjobë ndaj shoqërive që veprojnë në tregun e sigurimit të detyrueshëm, për produktin Policë Kufitare.

Me këtë vendim Komisioni vendosi ndalimin e akt-marrëveshjes së datës 05.04.2005 “Mbi themelimin e *Pool*-it të Sigurimit Kufitar të Përgjegjësive ndaj palëve të treta të mbajtësit të mjetit motorik”, e lidhur nga 8 (tetë) shoqëri sigurimi, që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimeve dhe konkretisht si marrëveshje e ndaluar me pasoja kufizuese për konkurrencën, mbasi fikson çmimin dhe ndan tregun si dhe vendosjen e gjobës në masën 2% të xhiros të vitit 2005, ndaj shoqërive pjesëmarrëse në marrëveshjen e datës 05.04.2005.

Komisioni i Konkurrencës e ka vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme sjelljen në bllok të shoqërive të sigurimit me pasojë rritjen e çmimit dhe mungesën e zgjedhjes konsumatore për shoqërinë e sigurimit në kundërshtim me parimet e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe është shprehur me vendimet nr. 50 dt. 21.3.2007 dhe nr. 246, datë 09.10.2012 lidhur me vendosjen e gjobave të rënda ndaj shoqërive të sigurimeve dhe dhënies së rekomandimeve për AMF-në (vendimet e Komisionit të

Konkurrencës nr. 28, dt. 23.12.2005, nr. 49 dt. 21.3.2007, nr. 247, datë 09.10.2012 “Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)”).

Si konkluzion, në zbatim të qëllimit të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” për përcaktimin e sjelljes së ndërmarrjeve për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, Komisioni i Konkurrencës gjykon se sjellja e ndërmarrjeve në treg bie në kundërshtim me parimet e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg duke rritur në masë të njëjtë dhe fiksuar për një periudhë tre ditore primet e shitjes së produktit MTPL, si dhe duke përdorur sistemin e shitjeve të përqendruara nëpërmjet Star Broker për të ruajtur pjesët e tregut. Për të patur një efekt real në ndërhyrjen në këtë treg, bazuar në nenin 45/2 të ligjit, Komisioni i Konkurrencës shprehet me kushte dhe detyrime, për të gjitha ndërmarrjet objekt hetimi, si instrument për rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik.

Komisioni i Konkurrencës mori vendimin me masa dhe detyrime sipas nenit 45/2 të ligjit duke kërkuar nga shoqëritë e sigurimit duhet të përmbushin brenda 90 ditëve nga marrja e këtij vendimi kushtet dhe detyrimet si vijon:

- a) Vënien në funksionim të programit *Bonus-Malus* për sistemin e individualizuar të sigurimit të detyrueshëm bazuar në të dhënat e të siguruarit, mjetit, historikut të dëmeve të shkaktuara dhe vendndodhjes;
- b) Ofrimi i shoqërisë së sigurimit sipas kërkesës së të siguruarit. Në sistemin e ofruar nga shoqëritë e brokerimit dhe agjentët e shoqërive të sigurimit duhet të shfaqen në kohë reale logot e të gjitha shoqërive të sigurimit me te cilat agjenti ose brokeri kanë marrëveshje për tregtimin e policës së sigurimit të detyrueshëm motorik;
- c) Të zbatojnë parashikimin ligjor për pagesën e dëmit nga siguruasi i drejtpërdrejtë;
- d) Të lidhin marrëveshje me më shumë se 1 shoqëri brokerimi sipas kriterëve të parashikuara nga AMF-ja lidhur me sistemin *online* të sigurimeve të detyrueshme dhe sistemit bankar për pagesat sipas legjisllacionit në fuqi;
- e) Shtypja dhe tregtimi i policave të sigurimit me logon e secilës ndërmarrje; Mospërmbushja e këtyre kushteve dhe detyrimeve sipas nenit 45/2 të ligjit do të sjellë si pasojë vendosjen e masës së gjobës për shkelje të rënda deri në 10 për qind të xhiros sipas nenit 74, pika 1, germa c.

V.2.5 Prokurimet Publike

Marrëveshjet e ndaluara në oferta janë praktika të ndaluara në të gjitha vendet pjesëmarrëse të OECD-së dhe si të tilla duhet të hetohen dhe sanksionohen sipas ligjit dhe rregullave të konkurrencës. Në disa vende të OECD-së, marrëveshjet në oferta janë të klasifikuara si vepra penale. Prokurimet publike në Shqipëri zënë rreth 15% të Produktit të Brendshëm Bruto (GDP) dhe kjo përqindje është e njëjtë me mesataren e prokurimeve publike në vendet e OECD-së me 15% të GDP-së.

Marrëveshjet e ndaluara në oferta ndodhin kur ndërmarrjet (operatorët ekonomik), të cilët supozohet të konkurrojnë, në mënyrë të fshehtë bien dakord për rritjen e çmimeve ose uljen e cilësisë së produkteve (të mirave apo shërbimeve) për blerësit (autoritetet kontraktore), të cilët dëshirojnë të sigurojnë produktet dhe shërbimet nëpërmjet një procesi prokurimi. Organizatat publike dhe private shpesh mbështeten në një proces

konkurrues ofertash për të realizuar një përdorim sa më të mirë të parasë. Çmimet e ulëta dhe/apo produktet e mira janë të dëshirueshme sepse ato mund të përdoren si rezerva, për më tepër kur ruhen, apo janë të lira për tu përdorur në shërbime dhe të mira të tjera. Një proces konkurrues mund të sigurojë çmime të ulëta, apo cilësi më të mirë dhe ndryshim (risi) vetëm nëse ndërmarrjet (operatorët ekonomik) konkurrojnë me të vërtetë (vendosin kushtet dhe kriteret e tyre me ndershmëri dhe në mënyrë të pavarur).

Marrëveshjet e ndaluara në oferta mund të bëhen në veçanti të dëmshme, nëse ato prekin prokurimet publike. Këto marrëveshje sjellin pasoja për blerësit dhe taksapaguesit, ulin besimin publik në një proces konkurrues dhe zvogëlojnë përfitimet nga një treg konkurrues.

Marrëveshjet e ndaluara në oferta mund të paraqiten në shumë forma, çdo njëra prej të cilave pengon përpjekjet e blerësve (autoriteteve kontraktore) për të siguruar produkte me çmimin më të ulët të mundshëm. Shpesh, konkurrentët bien dakord më përpara se cili do paraqesë ofertën fituese në një kontratë, duke bërë që të duket një proces ofertash konkurruese. Një objektiv i përbashkët i marrëveshjeve në oferta është të rrisin vlerën e ofertës fituese dhe po kështu rritet edhe vlera që ofertuesi fitues do të marrë.

Skemat e marrëveshjeve në oferta shpesh përfshijnë mekanizma për ndarjen dhe shpërndarjen e fitimeve shtesë të arritura si rezultat i çmimit final shumë të lartë të kontraktuar nëpërmjet ofertuesve bashkëpunues. P.sh. konkurrentët të cilët kanë rënë dakord të mos ofertojnë ose të paraqesin një ofertë jo fituese.

Detyra e Autoritetit të Konkurrencës është mbrojtja e konkurrencës me qëllim ndalimin e marrëveshjeve në oferta, të zbulimit dhe raportimit të shkeljeve të rasteve të mundshme në procedurat e prokurimit për bashkëpunimet potenciale: - Parandalimi i “*collusion*” në prokurimet publike; - Ndërgjegjësimi i pjesëmarrësve në tendera për pasojat nga koordinimi i sjelljes; - Rritja e konkurrencës dhe efikasitetit të prokurimeve publike. Autoriteti i Konkurrencës ka ndërmarrë këto hapa ku ka botuar: 1. Udhëzim “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”; 2. Guidë “Mbi zbulimin dhe reduktimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike” (në ndihmë të zyrtarëve të prokurimeve publike); 3. Flet-Palosje “Për sinjalet e një marrëveshje të ndaluar në oferta në prokurimet publike”. AK vlerëson bashkëpunimin me institucionet qeveritare për të luftuar marrëveshjet në oferta. Për këtë qëllim janë lidhur Memorandume Bashkëpunimi me Institucionet e përfshira si: Agjencia e Prokurimeve Publike, Komisioni i Prokurimeve Publike, Njësia Anti-korrupsion (në Këshillin e Ministrave), Prokuroria e Përgjithshme, Avokati i Prokurimeve Publike për bashkëpunim me qëllim evidentimin dhe parandalimin e Marrëveshjeve në Oferta në prokurimet publike.

Autoriteti i Konkurrencës ka rekomanduar: amendimin e Ligjit “Për Prokurimin Publik”, Neni 13, pika 3, sipas se cilit APP përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik për një periudhë 1-3 vjet edhe për rastet kur ai merr pjesë në marrëveshjet në oferta (rekomandim i cili u pasqyrua në ndryshimet që iu bënë LPP në vitin 2012); përfshirjen në dokumentet standarde të tenderit të Çertifikatës për oferte të pavarur; trajnimin e zyrtarëve të prokurimit publik rreth Marrëveshjeve në Oferta dhe sinjalizimin e AK lidhur me rastet e dyshuara për

marrëveshje në oferta; botimin e fletë-palosjes dhe shpërndarja tek çdo zyrtar i ngarkuar me prokurimet publike; botimin e Udhëzuesve mbi Marrëveshjet e fshehta në Ofertime; ndërgjegjësimin e bizneseve dhe publikut për luftimin e marrëveshjeve në oferta.

Udhëzimi “Mbi luftimin e Marrëveshjeve të Ndalura në Oferta” është një akt i mirëfilltë nënligjor, i cili trajton në mënyrë të plotë e të zgjeruar, që nga skemat e *bid rigging* deri tek hapat që duhet të ndërmarrin zyrtarët e prokurimeve për të njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës, në rast se vërehen shenja të marrëveshjeve në oferta. Ky udhëzim përmban të dhëna dhe sinjale për AK dhe APP. Kjo është metodologjia që aplikon OECD për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike. Kjo metodologji jep në hollësi: - Format më të njohura të marrëveshjeve në oferta (skemat); - Karakteristikat që ndihmojnë në marrëveshjet e fshehta; - Projektimin e procesit të prokurimit, për të reduktuar riskun e marrëveshjeve në oferta; - Projektimin e procesit të prokurimit, për të rritur pjesëmarrjen e mundshme të ofertuesve të sinqertë (të vërtet); - Projektimin e procesit të prokurimit, në mënyrë që të reduktohet komunikimi midis ofertuesve; - Formularë për të detektuar marrëveshjet në ofertimet e bëra në prokurimet publike.

Manualet (Guida) janë për projektimin e tenderave në mënyre të shkurtuar që të zbulohen, reduktohen marrëveshjet në oferta, në praktikë, në përdorim për nëpunësit e prokurimeve publike. Manualet u referohen konkretisht hapave që do të ndërmerren gjatë projektimit nga zyrtarët e prokurimeve dhe kjo e lehtëson njohjen e zyrtarëve sepse nuk kanë njohuri deri në këtë fazë, si dhe i bën ato të fokusohen drejtpërdrejtë në shenjat që mundësojnë lidhjen e një marrëveshjeje.

V.2.6 Sektori Farmaceutik

Sektori Farmaceutik është organizuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar. Ligji përcakton rregullat për prodhimin, vendosjen në treg, importin, eksportin, tregtimin, përdorimin, farmakovigjilencën, publicitetin, kontrollin e cilësisë dhe inspektimin e veprimtarive që lidhen me barnat për përdorim njerëzor në Republikën e Shqipërisë, me qëllim garantimin e shëndetit publik.

Ky sektor përfshin prodhimin, importin dhe tregtimin e barnave të cilat i rekomandohen pacientit sipas situatës shëndetësore në të cilën ndodhet.

Nevojat për barna mbulohen nga prodhimi vendas dhe importi, pas regjistrimit të barnave pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Tregu farmaceutik është një treg i hapur dhe i liberalizuar. Kriteret e përcaktuara në licencimin e ndërmarrjeve të reja në treg nuk përbëjnë barriera për hyrës të rinj dhe për më tepër vendosja e tyre është shumë e rëndësishme për sigurimin e një shërbimi cilësor dhe të sigurt për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Për shkak të specifikave që ka kërkesa dhe oferta për këtë produkt, ky treg ka disa specifika që e veçojnë nga tregjet e tjera. Ndryshe nga tregjet e të mirave, kërkesa për barna nuk përcaktohet drejtpërsëdrejti nga konsumatori (pacienti) por nga mjeku, sipas nevojës shëndetësore të pacientit. Pra kërkesa për ilaçe është inelastike dhe konsumatori nuk ka rol në vendimmarrje për zgjedhjen e cilësisë apo të çmimit.

Nga ana e ofertës, ky treg duhet të karakterizohet nga konkurrenca brenda markës dhe konkurrenca midis markave. Pavarësisht se prodhimi vendas zotëron një pjesë të vogël të tregut farmaceutik dhe pjesa e barnave patentë (shqiptare) dhe investimet në fushën e zbulimit dhe inovacionit janë të vogla, rregullat e Bashkimit Evropian dhe

më tej në fushën e të drejtës së patentës dhe në politikat për rritjen e konkurrencës mes markave kanë pasoja të drejtpërdrejta në tregun shqiptar⁵.

Konkurrenca brenda markës mund të ndikohet nga kufizimi i sasisë së barnave patentë duke mos arritur të mbulojë nevojën për medikamentin dhe duke ndikuar në rritjen e “importeve paralele” dhe në politika diskriminuese të çmimeve. Nga ana tjetër është shumë e rëndësishme të sigurohet hapja e tregut pas përfundimit të afatit të patentës duke i dhënë mundësi prodhuesve xhenerik të ofrojnë zëvendësuesit xhenerik me çmime të përballueshme për konsumatorët.

Në Shqipëri, çmimi i barnave në treg është i kontrolluar përmes marzheve të fabrikimit dhe të tregtimit, që përcaktohen me vendime të qeverisë. Kontrolli mbi çmimet e barnave bëhet edhe më i rëndësishëm për shkak se një pjesë e barnave, janë të rimbursueshme duke rënduar buxhetin e shtetit.

Për këto arsye është e kuptueshme që tregu farmaceutik nuk mund të funksionojë në kushtet e konkurrencës se lirë por pavarësisht rregullimit, tashmë është e pranuar gjerësisht se konkurrenca mund dhe duhet të luajë një rol kryesor në mirëfunksionimin e tregut për më shumë përfitime për pacientët, më shumë zgjedhje, produkte më inovative dhe çmime më të ulta.

Mbetet sfide e Autoritetit të Konkurrencës, vlerësimi i vazhdueshëm i tregun farmaceutik për të siguruar nga aktoret në treg, qofshin këta institucione apo ofrues të barnave, një transparencë në procedurat e regjistrimit të barnave duke mos krijuar barriera në hyrjen në treg të patentave apo barnave xhenerik (zëvendësues); transparencën në përcaktimin e çmimit të barit nëpërmjet vlerësimit të çmimit të blerjes apo uljeve të aplikuara nga prodhuesit farmaceutik, me qëllim përfitimin e çmimeve të lira nga konsumatorët (pacientët); rritjen e shkallës së informacionit mbi barnat e regjistruar dhe të drejtën e pacientit, që në bashkëpunim me mjekun zgjedh alternativën më të mirë për mjekim.

⁵ http://ec.europa.eu/competition/sectors/pharmaceuticals/2007_1_39.pdf,

VI. AVOKATIA E KONKURRENCËS DHE BASHKËPUNIMI ME ENTET RREGULLATORE

VI.1 Avokatia e konkurrencës dhe mjetet në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës

Politika Kombëtare e Konkurrencës mund të realizojë synimet e saj nëpërmjet dy rrugëve kryesore. Rruga e parë lidhet me veprimtarinë bazë të Autoritetit të Konkurrencës, veçanërisht me vendimmarrjen për zbatimin e ligjit. Rruga e dytë, që ka të bëjë me avokatinë dhe rritjen e kulturës së konkurrencës, lidhet me sfera të tëra të veprimtarisë së Autoritetit, të cilat kërkojnë bashkëpunim me organe e institucione të tjera.

Sipas përkufizimit të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës⁶, avokatia e konkurrencës u referohet atyre veprimtarive të ndërmarra nga Autoriteti i Konkurrencës për promovimin e një mjedisi konkurrues për veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve, me anë të mekanizmave jodetyruese, që realizohen kryesisht, nëpërmjet marrëdhënieve me agjencitë publike dhe nëpërmjet ndërgjegjësimit të publikut për përfitimet nga konkurrenca.

Autoriteti ka për kompetencë:

- vlerësimin e nivelit të kufizimit të konkurrencës nga aktet normative në fuqi sipas nenit 82, pika 1;
- vlerësimin e çështjeve që lidhen me konkurrencën dhe me legjislacionin në këtë fushë, sipas kërkesës së komisioneve parlamentare;
- vlerësimin dhe rekomandimin e ndryshimeve të akteve juridike që lidhen me zbatimin e konkurrencës nga organet e administratës qendrore dhe vendore, si dhe për institucionet e tjera publike, shoqëritë tregtare, organizatat e konsumatorëve, dhomat e tregtisë dhe të industrisë, grupet e interesit etj. (neni 69; neni 24, germa f).

Neni 70 parashikon rolin e Autoritetit lidhur me rregullimin dhe reformën rregullatore. Sipas këtij neni, (i) Autoriteti, për zbatimin e këtij ligji në sektorët e rregulluar, bashkëpunon me entet dhe institucionet e tjera rregullatore; (ii) barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik e administrativ, për arsye të interesit të përgjithshëm, vlerësohen nga Autoriteti duke bërë rekomandimet përkatëse. Në realizimin e këtij funksioni, Autoriteti i Konkurrencës duhet të luajë një rol të rëndësishëm në përzgjedhjen e kujdesshme të përparësive që kanë të bëjnë, në radhë të parë, me plotësimin e hapësirave për zbatimin efektiv të ligjit, por edhe me sektorët e ekonomisë, të cilët krijojnë probleme ku preket konkurrenca. Këto synime mund të zgjidhen me bashkëpunimin e enteve rregullatorë dhe të institucioneve të tjera.

Administrimi i avokatisë së konkurrencës nuk është detyrë e thjeshtë. Shpesh ai krijon kundërveprime nga aktorët e ndryshëm të tregut, përfshirë këtu bizneset dhe shoqatat e tyre, apo institucione të ndryshme publike e private, si dhe grupe të ndryshme të

⁶ Sipas Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës, Kongresi i vitit 2002

interesit.

VI.2 Vlerësimi i projekt-akteve ligjore dhe nënligjore

Për rritjen e efikasitetit të avokatisë dhe politikës së konkurrencës, në nenet 69 dhe 70 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” përcaktohet se Autoriteti i Konkurrencës duhet të vlerësojë shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës, që rrjedh nga çdo projekt-akt normativ. Autoriteti i Konkurrencës do të vlerësojë, në veçanti, ato projekt-akte që parashikojnë kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe për tregtinë; që vendosin të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta në zona të caktuara; për ndërmarrje ose prodhime të përcaktuara; që parashikojnë të njëjtat praktika për çmimet ose kushtet e shitjes, ose që mund të rritin barrierat në hyrje, përfshirë këtu edhe rregullimin ekonomik e administrativ.

VI.2.1 Kufizimet sasiore

Tregu funksionon në mënyrë eficiente kur ofruesit mund të zgjerojnë kapacitetin e prodhimit dhe ofrues të tjerë të kenë mundësi të hyjnë në treg. Në këto kushte, konkurrenca bën të mundur uljen e çmimeve dhe rritjen e cilësisë. Konsumatorët do të kenë mundësi të zgjedhin ndërmjet prodhimeve të ndryshme dhe të ushtrojnë trysni ndaj çmimeve. Në tregjet ku legjislacioni parashikon kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin, konkurrenca nuk mund të jetë efektive, gjë që çon në uljen e prodhimit, në çmime të larta dhe në uljen e cilësisë. Kufizimet sasiore për hyrjen në treg përfshijnë çdo lloj rregulli që kufizon numrin e ofruesve të prodhimeve ose të shërbimeve në treg. Kufizimi mund të ushtrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Rregulla që shtojnë koston dhe parashikojnë kushte të panevojshme për kryerjen e një veprimtarie ekonomike, shtojnë barrierat në hyrje, duke kufizuar kështu konkurrencën potenciale. Kushtet që duhet të përmbushin personat fizikë ose juridikë për ushtrimin e një veprimtarie ekonomike duhet t'i përkohjnë një interesi publik, për shembull mbrojtjes së shëndetit apo rendit publik, mbrojtjes së konsumatorëve ose të kreditorëve. Nëse kushtet e vëna nuk janë parashikuar për të mbrojtur publikun në përgjithësi, kufizimi i hyrjes në treg dhe kufizimi i njëkohshëm i konkurrencës nuk justifikohet.

Gjithashtu, masat e marra duhet të jenë në përpjesëtim të drejtë me interesin që parashikohet të mbrohet. Vendosja e barrierave në hyrje, që nuk mund të justifikohen me mbrojtjen e interesit publik, kufizon në mënyrë të pajustificueshme konkurrencën. Autoriteti i Konkurrencës do të vlerësojë projekt-aktet ligjore ose nënligjore që rritin koston e hyrjes në treg dhe fillimin e një veprimtarie ekonomike në çdo sektor të ekonomisë shqiptare.

Autoriteti i Konkurrencës do të vlerësojë, gjithashtu, gjendjen e konkurrencës në tregun e ofrimit të shërbimeve nga profesionet e lira. Këtu përshihen shërbimet e avokatisë, të ekspertizës kontabël, inxhinierët ose arkitektët. Kushtet e hyrjes në treg, për shembull për marrjen e licensave, nuk duhet të kenë si qëllim kufizimin e numrit të ofruesve.

Kufizimet sasiore të tregtimit pengojnë ofruesit ekzistues të rritin sasinë në treg. Por ulja e ofertës sjell rritjen e çmimeve. Kufizime të tilla duhet të shmangen që në fazën e

përgatitjes së projekt-akteve ligjore dhe nënligjore.

VI.2.2 Të drejtat ekskluzive

Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar) me ndryshimet që pësoi në vitin 2010, ka parashikuar në fushën e zbatimit të tij në nenin 2, pika 1 germa c) edhe ato ndërmarrje publike dhe ndërmarrjet të cilave iu janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta.

Në këtë kuadër, Autoriteti i Konkurrencës, si pjesë e pandarë e procesit të integritit të Shqipërisë në BE, ka detyrimet e tij për plotësimin e të gjitha kërkesave që shtrohen nga Komisioni Evropian, dhe që janë pjesë e procesit të stabilizim Asocimit. Autoriteti i Konkurrencës është lider dhe koordinues i një nga Kapitujve më të rëndësishëm për të cilët kërkon informacion të hollësishëm Komisioni Evropian, kapitulli 8 “Politika e Konkurrencës”. Ky kapitull ndahet në tre nënkapituj që janë pjesa e konkurrencës, e ndihmës Shtetërore dhe pjesa e Liberalizimit. Për sa i përket Liberalizimit, Autoriteti i Konkurrencës ka pasur në fokus të veprimtarisë së tij, një sërë të drejtash ekskluzive dhe të veçanta të dhëna në Shqipëri.

Vlerësimi i të drejtave ekskluzive dhe të veçanta, bazuar në nenin 69 të Ligjit, është një vlerësim i cili duhet të kryhet ex-ante, përpara dhënies së të drejtës, ku lind detyrimi i organeve të administratës qendrore dhe vendore që të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit për çdo projekt akt normativ që ka të bëjë kryesisht me kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin; vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, apo imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet shitjes. Në këtë rast vlerësohen nga Autoriteti i Konkurrencës shkalla e kufizimit ose e pengimit të konkurrencës.

Gjithashtu, kemi edhe vlerësimet *ex-post*, vlerësime të cilat kryhen pas dhënies së të drejtës ekskluzive apo të veçantë dhe që kanë të bëjnë me respektimin e rregullave të konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve që gëzojnë këto të drejta. Autoriteti i Konkurrencës ka vlerësuar ex-post të drejta të veçanta dhe ekskluzive të dhëna nga institucione të ndryshme në Shqipëri, duke pasur parasysh mbrojtjen dhe ruajtjen e parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i të gjitha kontratave konçesionare, ka rezultuar se gjatë procedurës për dhënien e koncesioneve nuk është respektuar detyrimi i nenit 2/1c dhe 69/1/b të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” pasi institucionet përgjegjëse në çdo rast nuk kanë zbatuar detyrimin për të marrë vlerësimin e Autoritetit gjatë procedurës së dhënies së të drejtave ekskluzive.

Janë vlerësuar marrëveshjet konçesionare në sektorin e shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve; marrëveshja konçesionare për Terminalin Lindor të Portit të Durrësit; marrëveshja konçesionare për shërbimin e skanimit të automjeteve; marrëveshja konçesionare për pullat fiskale, marrëveshja konçesionare për Lotarinë Kombëtare.

Vendosja e të drejtave ekskluzive ose e të drejtave të veçanta në zona të caktuara kufizon ndjeshëm konkurrencën. Dhënia e të drejtave ekskluzive një ose disa operatorëve, kufizon mundësinë e operatorëve të tjerë të ofrojnë prodhime në një treg të caktuar. Kufizimi i konkurrencës rrjedh në radhë të parë nga ulja e sasisë së ofruar në treg dhe rritja e çmimit. Gjithashtu, numri i reduktuar i ofruesve në treg sjell uljen e

cilësisë. Vendosja e së drejtës ekskluzive për ofrimin e një prodhimi një ndërmarrjeje të vetme krijon në treg një monopol ligjor. Një pozitë e tillë monopolistike i jep mundësi ndërmarrjes të vendosë çmime të larta.

Nuk duhet harruar se dhënia e të drejtave ekskluzive ose të veçanta kufizon ndjeshëm lirinë ekonomike dhe, njëkohësisht, bie ndesh me parimin e ekonomisë së tregut të sanksionuar në nenin 11 të Kushtetutës së Shqipërisë. Kufizime të tilla mund të vendosen vetëm për arsye të ligjshme publike. Për më tepër, këto kufizime duhet të jenë në përpjesëtim me objektivin e mbrojtjes së interesit publik.

Një nga arsyet kryesore të dhënies së të drejtave ekskluzive është sigurimi për qytetarët i shërbimeve publike, për shembull i shërbimit postar, shërbimit të telekomunikacioneve, i sigurimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe ujit etj. Qëllimi kryesor i shërbimit publik (ose ndryshe shërbimit universal) është të sigurojë për të gjithë qytetarët mundësinë e një shërbimi cilësor me një çmim të arsyeshëm. Sipas këtyre parimeve, shërbimet duhet të ofrohen në mënyrë të vazhdueshme dhe me të njëjtin çmim si në zonat urbane ashtu dhe në zonat e largëta, të cilat mund të mos jenë fitim-prurëse. Një nga mënyrat e kompensimit të humbjeve dhe fitimeve në zona të ndryshme dhe për shtresa të ndryshme të popullsisë, për ofrimin e shërbimeve me të njëjtin çmim, është dhe dhënia e së drejtës ekskluzive një ndërmarrjeje shtetërore ose private për ofrimin e shërbimeve të interesit publik.

Autoriteti i Konkurrencës e njih rëndësinë e sigurimit të shërbimit publik për gjithë qytetarët e Republikës së Shqipërisë si një nga detyrat kryesore të shtetit. Autoriteti merr parasysh që dhënia e të drejtave ekskluzive justifikohet vetëm për ofrimin e një shërbimi publik të përkufizuar saktë në ligj dhe kur mënyrat e tjera të financimit nuk janë të mundshme ose të zbatueshme. Së pari, të drejtat ekskluzive, me përjashtime të rralla, mund të justifikohen vetëm për shërbime nga të cilat përfiton e gjithë popullsia dhe që konsiderohen si shërbime bazë. Të drejtat e veçanta dhe ekskluzive nuk justifikohen në rastin e shërbimeve dhe tregjeve që nuk konsiderohen si shërbime publike ose universale. Së dyti, meqë dhënia e të drejtave ekskluzive kufizon ndjeshëm konkurrencën, duke pasur kështu si pasojë uljen e cilësisë së shërbimeve dhe të sasisë dhe llojeve të ofruara në treg, ky mjet financimi duhet të mënjanohet, nëse janë të mundshme mënyra të tjera financimi. Një nga mënyrat e financimit është dhe krijimi i një fondi të përbashkët, i ushqyer nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtin treg ose tregje të të njëjtit sektor ekonomik. Një mënyrë tjetër është dhe financimi nëpërmjet ndihmës shtetërore, kur kjo nuk e kalon koston neto të ofrimit të shërbimit publik. Këto dy mënyra kanë më pak efekte kufizuese për konkurrencën.

Një nga rastet e tjera kur dhënia e të drejtave ekskluzive mund të quhet e justifikuar, është dhe nevoja për investime paraprake të rëndësishme dhe të pa-rikthyeshme. Kufizime të tilla të konkurrencës mund të jenë të nevojshme për hyrjen në treg të operatorëve të rinj, sidomos në tregje ku ende nuk operohet në Shqipëri. Investimet e mëdha bëjnë të mundur ofrimin e shërbimeve që nuk ofroheshin më parë, duke rritur kështu sasinë në treg. Në raste të tilla, të drejtat e veçanta ose ekskluzive mund të justifikohen nëse janë në përpjesëtim me nevojën për mbrojtjen paraprake të investimeve: së pari, shtrirja e ekskluzivitetit duhet të jetë në përpjesëtim me rëndësinë e investimeve; së dyti, kohëzgjatja e ekskluzivitetit duhet të jetë në përpjesëtim me nevojën për mbrojtjen e investimeve. Shtrirja kohore e një të drejte ekskluzive nuk duhet të kalojë atë që është e nevojshme për sigurimin e një kthimi normal të investimit, i

cili mbulon riskun e lidhur me hapjen e një veprimtarie ekonomike në Shqipëri.

Jashtë shërbimit publik dhe nevojave për investime të papërballueshme, dhënia e të drejtave ekskluzive i kundërvihet konkurrencës së lirë dhe efektive si dhe funksionimit të ekonomisë së tregut.

VI.3 Bashkëpunimi me entet rregullatorë

Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” kërkon bashkëpunimin e Autoritetit të Konkurrencës me institucionet e administratës qendrore dhe vendore. Në këtë kuadër, del i domosdoshëm forcimi i bashkëpunimit të Autoritetit të Konkurrencës me këto ente rregullatorë.

Për të rritur zbatueshmërinë e ligjit, Autoriteti i Konkurrencës po bashkëpunon me entet rregullatorë. Përcaktimi dhe njohja e ndërsjellë e këtyre përgjegjësive shmang mbivendosjen e akteve juridike të dala nga këto institucione dhe mënjanon ndërhyrjet në kompetencat ligjore të njëri-tjetrit.

Mënyrat e veçanta të bashkëpunimit janë përcaktuar në memorandumet e bashkëpunimit midis Autoritetit të Konkurrencës dhe enteve rregullatorë. Autoriteti i Konkurrencës kur konstaton kufizime dhe shtrembërime të konkurrencës në treg, si rrjedhojë e një barriere administrative, por nuk mundet të ndërhyjë me vendim të drejtpërdrejtë, që do të prekte autonominë e institucioneve, mund t’i drejtojë entit rregullator ose institucionit të ngjashëm dhe me funksion të barabartë me të, rekomandime për masat që duhet të marrë, që instrumentet e përdorura të jenë në përputhje me objektivin e përcaktuar.

VI.4 Krijimi i kulturës së konkurrencës

Një ndër rrugët e rëndësishme për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, vlerësohet krijimi i një kulture konkurrence në mjedisin shqiptar.

Pavarësisht krijimit të Autoritetit të Konkurrencës dhe përqasjes me legjislacionin evropian të konkurrencës, në Shqipëri ende mungon një kulturë konkurrence në të gjitha nivelet e ekonomisë, duke përfshirë hartimin e politikave publike, komunitetin e biznesit dhe publikun e gjerë.

Mungesa e kulturës të konkurrencës mbetet ende një problem që prek aftësinë e autoriteteve përkatëse për zbatimin e ligjit të konkurrencës dhe avokatisë të saj në reformat rregullatore ose në reformat ekonomike në përgjithësi, për t’u bazuar në parimet e konkurrencës. Për rrjedhojë, rritja e vetëdijes së aktorëve (politik-bërësve, komunitetit të biznesit, publikut) me çështjet e politikës së konkurrencës është një ndër detyrat më të mprehta të Autoritetit.

Hartimi, miratimi dhe publikimi i dokumentit “Politika Kombëtare e Konkurrencës” është një instrument bazë për realizimin e këtij synimi dhe ka, midis të tjerash, si qëllim të ndihmojë komunitetin e biznesit dhe konsumatorët të kuptojnë rregullat e funksionimit të legjislacionit, të konkurrencës dhe mënyrën e funksionimit të tyre. Nëse sipërmarrjet dhe konsumatorët do të kenë njohuri më të mira për rregullat e lojës të tregut, atëherë ato do të mundohen të shmangin dhe/ose të denoncojnë

praktikat anti-konkurrese pranë Autoritetit të Konkurrencës.

Një drejtim i rëndësishëm për realizimin e këtij funksioni është vetë rritja e kulturës së konkurrencës dhe e kapaciteteve të stafit të Autoritetit, për të zbatuar ligjin dhe për të interpretuar vendimet sipas përvojës dhe standardeve ndërkombëtare. Një element i nevojshëm për realizimin e këtij funksioni është përkthimi dhe publikimi i fjalorit të termave kryesorë të përdorur në politikën evropiane të konkurrencës, si dhe hartimi i një komentari për kuptimin dhe zbatimin e ligjit. Por thelbin për realizimin e këtij funksioni e përbëjnë komunikimi me institucionet e tjera, me komunitetin e biznesit dhe publikun lidhur me veprimtarinë e Autoritetit në tërësi dhe vendimmarrjen për zbatimin e ligjit në veçanti.

Rol të pazëvendësueshëm luan detyrimi ligjor i raportimit të përvitshëm në Kuvend, si dhe botimi e publikimi i Raportit e Buletinit Zyrtar të Autoritetit. Autoriteti duhet të organizojë sondazhe të herëpashershme me komunitetin e biznesit dhe publikun për kuptimin dhe problematiken e zbatimit të konkurrencës në tërësi dhe të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës në veçanti, me synim ndërtimin e një dialogu efektiv me komunitetin e biznesit dhe publikun.

Media duhet të jetë partner i rëndësishëm në përcjelljen e saktë të politikës së konkurrencës te aktorët e tregut. Nëpërmjet kanaleve të komunikimit të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet medias, Autoriteti i Konkurrencës do të mundohet të përçojë mesazhet te komuniteti nëpërmjet instrumenteve të njohura të marrëdhënieve me publikun, si:

- një faqe interneti për komunikim të brendshëm dhe me jashtë,
- organizmi i konferencave, seminareve, workshopeve,
- konferenca për shtyp,
- intervistat,
- shkrimet dhe emisionet,
- publikimet,
- trajnime gazetareve,
- leksionet dhe bashkëpunimi me arsimin etj.,
- që janë hapat e parë më se të nevojshëm për realizimin e këtij funksioni.

VII. INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

VII.1 Përafrimi i legjislacionit të konkurrencës me atë të BE-së

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian nënkupton ecjen në një hap me institucionet evropiane dhe përafrimin me vlerat dhe parimet që ato përfaqësojnë. Bashkësia evropiane, funksionon mbi këto vlera dhe parime, të cilat duhet të bëhen pjesë e zbatueshme nga ana jonë, dhe në këtë mënyrë ne i afrohem aspiratës tonë për tu bërë anëtarë të denjë e kësaj bashkësie.

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE) është objektivi më i rëndësishëm strategjik i vendit. BE përfaqëson bashkimin politik dhe ekonomik më të madh në botë, që promovon standarde dhe vlera, të cilat përputhen me aspiratat dhe idealet e popullit shqiptar. Integrimi në BE konsiderohet në radhë të parë si një proces i brendshëm zhvillimi dhe progresi që është i lidhur me përmbushje standardesh dhe plotësim kriteresh të qarta. Në këtë proces, Shqipëria duhet të pranojë plotësisht përgjegjësitë e saj për përmbushjen e kriterëve të pranimit.

Përshpejtimi i procesit të integrimit në BE arrihet nëpërmjet përmbushjes së kriterëve të Kopenhagenit dhe duke harmonizuar legjislacionin me *Acquis Communautaire*. Hyrja e Shqipërisë në familjen evropiane shoqërohet me plotësimin e detyrimeve për sa i përket kriterit politik (demokracia, shteti ligjor, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve) si dhe kriterit ekonomike (funksionimi i ekonomisë së tregut dhe ngjitja e kapaciteteve për të përballuar presionin konkurrues në tregun e brendshëm evropian).

Integrimi Evropian i Shqipërisë është një nga sidat më të rëndësishme me të cilën po përballet Shqipëria, sidomos pas datës 24 qershor 2014, ku shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) i dhanë Shqipërisë statusin e vendit kandidat. Dhënia e statusit kandidat përbën vlerësimin që Bashkimi Evropian i ka dhënë Shqipërisë lidhur me reformat e ndërmarra, si dhe tregon se jemi duke ecur drejt procesit të integrimit evropian duke forcuar marrëdhënien me BE-në, dhe duke kaluar në një stad të avancuar këtë marrëdhënie.

Tashmë, në përputhje me detyrat dhe detyrimet e përcaktuara në MSA, Shqipëria duhet të ndërmarri reformat e duhura në kuadër të procesit të integrimit në BE. Elementi kyç i procesit të integrimit evropian është harmonizimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së dhe disa nga pjesët më të rëndësishme janë kapitujt e MSA mbi parashikimet ekonomike dhe tregtare përfshirë dispozitat për ligjin mbi konkurrencën.

Detyrimi për të përafruar legjislacionin në fushën e konkurrencës me standardet evropiane parashikohet në nenet 70 dhe 71 të MSA-së dhe disa nga kërkesat kryesore në këtë fushë përfshinë përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit, forcimin e autoriteteve kombëtar të konkurrencës, pavarësinë dhe forcimin e kapaciteteve administrative, rritje të kulturës dhe ndërgjegjësim për politikën dhe kulturën e konkurrencës. Sipas këtyre neneve, Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me legjislacionin evropian. Të gjitha këto kërkesa reflektojnë lidhjen direkte ndërmjet politikës efektive të konkurrencës dhe ekzistencës së ekonomisë së tregut të lirë si një parakusht për

asocimin evropian.

Hartimi dhe miratimi i legjislacionit rregullator dhe mbikëqyrës në fushën e konkurrencës, duke mundësuar zhvillimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit, është kontributi që jep edhe Autoriteti i Konkurrencës përgjatë procesit të integritimit në BE. Ky kuadër ligjor i plotësuar synon përafrimin me standardet ndërkombëtare, në kuadër të përmbushjes së angazhimeve të institucionit dhe të vendit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me BE.

Proçesi i përafrimit të legjislacionit mbetet një nga prioritetet kryesore të Autoritetit të Konkurrencës, pasi zbatimi i këtij proçesi bëhet jo vetëm për të ndërtuar kornizën ligjore në fushën e konkurrencës në përputhje me kërkesat e institucionit duke përshtatur dhe përfaruar *Acquis Communautaire*, por gjithashtu për të siguruar kushtet administrative dhe të tjera të nevojshme për zbatimin efektiv të saj.

Në zbatim të nenit 84 të ligjit nr. 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës", janë hartuar nga Autoriteti dhe miratuar nga Komisioni i Konkurrencës aktet nënligjore në fushën e konkurrencës, ku përfshihen rregulloret dhe udhëzimet përkatëse. Këto rregullore dhe udhëzime janë publikuar në faqen e internetit të Autoritetit. Hartimi dhe miratimi i legjislacionit dytësor për konkurrencën në përputhje me parimet e Bashkimit Evropian, plotëson kuadrin ligjor, duke mundësuar funksionimin e plotë të Autoritetit të Konkurrencës si një institucion publik i pavarur, përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe hyrjen në fuqi të Marrëveshjes të Ndërmjetme, në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian, janë parashikuar hartimi dhe përfarimi i një sërë rregulloresh dhe udhëzimesh mbi bazën e legjislacionit të BE-së. Autoriteti i Konkurrencës ka miratuar kuadrin ligjor sekondar që ka të bëjë me tre shtyllat e ligjit, rregulloren për marrëveshjet dhe mënyrën e vlerësimit të tyre, rregulloren për kontrollin e përqëndrimeve, vlerësimin dhe formularët përkatës, si dhe udhëzime që kanë të bëjnë me abuzimin me pozitën dominuese apo udhëzues të cilët lehtësojnë punën dhe sqarojnë nocionet e konkurrencës. Me rendësi është kuadri ligjor plotësues, lidhur me gjobat dhe përllogaritjen e tyre, si dhe rregulloret për respektimin e proçedurave hetimore apo mënyra e funksionimit të vetë institucionit të Autoritetit të Konkurrencës. Proçesi i përafrimit të legjislacionit është një proçes i cili vijon në përputhje jo vetëm të detyrimeve të Shqipërisë si vend kandidat i BE-së deri në anëtarësimin e plotë, por edhe domosdoshmëri e vet institucionit, për të rregulluar dhe sqaruar të gjitha dispozitat ligjore, gjithmonë në përputhje dhe në zbatim të ligjit parësor të konkurrencës.

VII.2 Bashkëpunimi me Bashkimin Evropian

Proçesi i Stabilizim-Asocimit për pesë vendet e Evropës Jug-Lindore, përfshi Shqipërinë, ka filluar që gjatë Samitit të Zagrebit të mbajtur në nëntor të vitit 2000. Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë nga njëra anë dhe Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij nga ana tjetër u nënshkrua në qershor 2006 dhe hyri në fuqi në prill të vitit 2009. Shqipëria paraqiti kërkesën e saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian më 28 prill 2009. Në Tetor 2012, Komisioni Evropian rekomandoi që Shqipërisë t'i jepet statusi i kandidatit me kusht plotësimin e masave kyçe në fushat e reformës gjyqësore dhe të administratës publike dhe rishikimin e rregullores së Parlamentit.

Kapitulli 8 "Politika e Konkurrencës", lider dhe koordinator i të cilit është Autoriteti i Konkurrencës është një nga Kapitujt kryesorë të *Acquis*, dhe kontribuon nëpërmjet dhënies së informacioneve për Komisionin Evropian në lidhje me Konkurrencën dhe Politikën e Konkurrencës në Shqipëri, Ndhimën Shtetërore si dhe Liberalizimin. Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian për Kapitullin 8 përbëhet nga përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, dhe institucioneve publike sipas sektorëve të ekonomisë.

VII.3 Bashkëpunimi Ndërkombëtar i Konkurrencës (ICN, UNCTAD, OECD)

Autoriteti i Konkurrencës i ka kushtuar dhe vazhdon t'i kushtojë rëndësi të veçantë bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e konkurrencës. Ky bashkëpunim nuk ka të bëjë vetëm me pjesën rregullatorë (të njëjtat rregulla dhe parime në fushën e konkurrencës), por edhe me aspektin bashkëpunues.

Harmonizimi i legjislacionit në fushën e konkurrencës me aktet ligjore të Bashkimit Evropian si edhe me tendencat më të fundit ndërkombëtare, ka qenë ndër synimet e rëndësishme në veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës. Realizimit të këtyre synimeve i ka shërbyer edhe mbajtja e një komunikimi të vazhdueshëm me institucionet homologe të konkurrencës. Pjesëmarrja aktive në veprimtaritë e organizuara prej organizmave ndërkombëtare, si edhe në forumet e nismat e ndryshme rajonale i kanë shërbyer reflektimit të praktikave më të mira në nismat rregullatorë të ndërmarra nga Autoriteti i Konkurrencës.

Si pjesë e strategjisë së zhvillimit institucional të saj, Autoriteti i Konkurrencës synon të intensivikojë marrëdhëniet dypalëshe dhe bashkëpunimin teknik të vendosur me institucionet homologe të konkurrencës. Krahas zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve me to, institucioni synon gjithashtu përfitimin e eksperiencës konkrete me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale.

VII.4 Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës, që prej vitit 2003, është anëtar me të drejta të plota i Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN), ku aderjnë dhe 65 autoritete të konkurrencës nga shumë vende të botës. Ky rrjet bashkëpunon ngushtë me organizatat ndërkombëtare, të tilla si: OECD (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik), OBT (Organizata Botërore e Tregtisë), UNCTAD (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin) etj. Ndonëse nuk ushtron funksionin si organizëm vendimmarrës, rrjeti kërkon t'u mundësojë autoriteteve të konkurrencës mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe diskutimin për çështjet praktike të konkurrencës. Nga kjo synohet arritja dhe përmirësimi i bashkëpunimit mbarëbotëror të autoriteteve të konkurrencës dhe arritja e politikave të përbashkëta të konkurrencës, përmes një dialogu të vazhdueshëm. Në këtë mënyrë, Autoriteti i Konkurrencës do të jetë vazhdimisht i angazhuar për të dhënë ndihmesën e tij në përgatitjen e materialeve, në kuadër të studimeve të ndryshme që kryhen nga ky rrjet për çështjet e konkurrencës.

VII.5 Marrëdhëniet me të tretët

Komunikimi me Publikun: Komunikimi me publikun përbën një hallkë të rëndësishme në aktivitetin e Autoritetit të Konkurrencës si në përmbushjen e detyrimit për të ofruar transparencë maksimale të vendimmarrjes dhe efektivitetit të saj, ashtu edhe për rritjen e besueshmërisë së publikut ndaj vendimeve të Komisionit të Konkurrencës. Një komunikim transparent ndihmon në përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes si dhe në përcjelljen e duhur të frymës së institucionit. Në këtë kuadër, është vlerësuar si shumë i rëndësishëm komunikimin ndërveprues me publikun.

Informimi i publikut dhe transparenca e institucionit: Autoriteti i Konkurrencës përdor një sërë kanalesh komunikimi për informimin e publikut me qëllim që të shpjegojë sa më qartë objektivin e veprimtarisë së institucionit. Ndër to mund të përmendim:

- Marrëdhëniet me **median:** Për të patur një komunikim sa më transparent, vihen në funksion një sërë instrumentash, ndër të cilat përmendim median e shkruar dhe atë vizive, që siguron informimin në kohë reale mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës dhe tregjet apo sektorët e ekonomisë në të cilat Autoriteti ndërhyt për rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive.
- Daljet në **Publik:** Rëndësi e veçantë i kushtohet fjalimeve, prezantimeve dhe materialeve të mbajtura në aktivitete të ndryshme organizuar nga Autoriteti i Konkurrencës apo edhe organizma të tjerë ku është prezantuar aktiviteti dhe veprimtaria e Autoritetit të konkurrencës.
- **Botimet:** Botimet ofrojnë informacion të zgjeruar e të përditësuar mbi çështje dhe tema të ndryshme të konkurrencës, mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës apo edhe mbi gjithë veprimtarinë e institucionit.
- Faqja e **internetit:** Autoriteti i Konkurrencës ofron transparencë të plotë, duke publikuar në kohë reale çdo vendim të Komisionit të Konkurrencës si dhe nëpërmjet njoftimeve për shtyp është transmetuar informacion mbi aktivitetin e institucionit, vendimet e Komisionit, analiza dhe studime të ndryshme të ndërmarra në treg, raporte të ndryshme apo publikime të institucionit, etj.

VII.6 Bashkëpunimi në të ardhmen

Autoriteti i Konkurrencës, duke qenë pjesë e procesit të integritimit evropian, anëtar në Rrjetin Ndërkombëtar të Konkurrencës dhe pjesë e procesit të bashkëpunimit mes autoriteteve të konkurrencës në rajon, do të jetë gjerësisht i angazhuar në forcimin e bashkëpunimit dhe vendosjen mbi bazat institucionale të këtij bashkëpunimi. Nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit me vendet e rajonit do të shtrojë “shinat” e një bashkëpunimi konkret në hetimin e rasteve të përbashkëta të marrëveshjeve të fshehta, bashkimeve ose abuzimeve me pozitën dominuese. Autoriteti i Konkurrencës po punon për rritjen e aftësive teknike dhe profesionale të stafit të tij.

Për këtë, Autoriteti i Konkurrencës është pjesëmarrës i vazhdueshëm në një sërë trajnimesh, konferencash dhe seminaresh për vendet e Evropës Juglindore, të organizuara nga OECD-ja, Komisioni Federal i Tregtisë, në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë së SHBA-së, GIZ-i, etj. Në të gjitha këto veprimtari përfaqësuesit e Autoritetit janë aktive në diskutime me çështjet e trajtuara, si dhe parashetrojnë zgjidhjet e rasteve të shqyrtuara nga ky autoritet.

Autoriteti i Konkurrencës synon të zhvillojë politikën e konkurrencës, duke forcuar bashkëpunimin me strukturat homologe të konkurrencës në vendet e Evropës Juglindore, me ato të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Konkurrencës në Bruksel.

VIII. DREJTIMET KRYESORE TË RITJES SË EFEKTIVITETIT TË POLITIKËS DHE TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

Dokumenti Politika Kombëtare e Konkurrencës synon të shërbejë si një instrument:

- për kuptimin dhe zbatimin të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, për sjelljen e aktorëve privatë dhe publikë në përputhje me rregullat e konkurrencës dhe të tregut të lirë.;
- për rritjen e vetëdijes për rolin e konkurrencës në zhvillimin ekonomik të vendit dhe integrimin e tij rajonal, evropian e botëror;
- për komunikimin e ndërsjellë të Autoritetit të Konkurrencës me publikun, komunitetin e biznesit dhe institucionet publike, por edhe me organizmat homologë ndërkombëtarë gjatë hartimit dhe zbatimit të politikës kombëtare të konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës është institucioni përgjegjës i ngarkuar për zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Por ai nuk është institucioni i vetëm për realizimin e tij. Zbatimi e detyrimi i ligjit, sjellja e ndërmarrjeve dhe aktorëve të tjerë, në përputhje me rregullat e konkurrencës të një ekonomie funksionale tregu, varet shumë edhe nga qëndrimi i institucioneve qendrore dhe vendore, gjykatës, medias, enteve rregullatore, biznesit dhe shoqatave të tij, shoqatave të konsumatorëve dhe publikut të gjerë.

Autoriteti është dhe do të jetë i hapur për bashkëpunim e bashkëveprim të frytshëm me të gjitha palët e interesuara për realizimin e një konkurrencë të lirë, efektive dhe të ndershme.

Ndër synimet dhe drejtimet kryesore të Politikës Kombëtare të Konkurrencës dhe të veprimtarisë së Autoritetit në periudhën 2007-2008 do të veçojmë:

VIII.1 Përsosja e kuadrit ligjor

Autoriteti ka për synim të përmbushë angazhimet e marra në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe Marrëveshjes së Ndërmjetme me BE-në. Së pari, të plotësohet kuadri ligjor dhe nënligjor me rregulloret e udhëzimet përkatëse, duke mbajtur parasysh Planin e Përafrimit të Legjislacionit dhe zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit me BE-në, si dhe hapësirat e nevojshme dhe të domosdoshme për një zbatim efektiv të ligjit. Së dyti, përsosja e kuadrit ligjor do të synojë që, në përputhje me përvojën e fituar, rritjen e kapaciteteve dhe kërkesat e zhvillimit të një ekonomie funksionale dhe konkurruese tregu, të bëhen amendimet dhe plotësimet përkatëse në ligj, që të merren parasysh nevojat e zhvillimit ekonomik në vend.

Politika e konkurrencës pasqyron vizionin dhe qëllimin që ka Autoriteti i Konkurrencës për të përshpejtuar procesin e integritit evropian dhe përcakton qartësisht synimin tonë që të arrijmë ta afrojmë Shqipërinë me BE-në. Kjo Politikë po ashtu paraqet një vlerë të shtuar ndaj procesit në vazhdimësi të integritit evropian, i cili do të forcohet kur të fillojnë negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Komisionin Evropian (KE) duke sjellë Shqipërinë më afër anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Përmirësimi i sundimit të ligjit do të arrihet duke modernizuar, plotësuar dhe forcuar kuadrin ligjor në fushën e konkurrencës, përmes reformave të gjithanshme dhe të matshme, të bazuara në parimet e Kushtetutës dhe praktikave më të mira evropiane, si dhe duke rritur bashkëpunimin me institucionet shtetërore, me biznesin dhe palët e treta, me synim zbulimin e praktikave anti-konkurrese.

Kuadri ligjor në fushën e konkurrencës, është hartuar dhe vijon të zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e BE-së. Ligjet e vendit duhet të zbatohen me rigorozitetin që nevojitet për të vendosur besimin në institucionet tona, për të nxitur zhvillimin e ekonomisë dhe për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve.

Në kuadër të vëmendjes së Autoritetit të Konkurrencës edhe në vitet në vijim, do të jetë përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullativ nëpërmjet hartimit të ligjeve dhe rregulloreve apo amendimeve të tyre, rritja e shkallës së përafrimit me direktivat e BE-së dhe me standardet e parimet ndërkombëtare të konkurrencës. Janë identifikuar nevojat për përmirësime të mëtejshme legjislative në fushën e konkurrencës të cilat janë pasqyruar edhe në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian. Kuadri ligjor dytësor i Autoritetit të Konkurrencës synon të jetë në përputhje me ndryshimet dhe risitë evropiane, duke pasqyruar çdo ndryshim të mundshëm të tij, jo vetëm si një detyrim institucional dhe ligjor në kuadër të procesit të stabilizimit asociimit, por edhe me objektivat për ta bërë tregun shqiptar të pajtueshëm dhe funksional sipas të njëjtave rregullave dhe parimeve që veprojnë që Evropë.

VIII.2 Zhvillimet institucionale

Nga pikëpamja institucionale, Autoriteti i Konkurrencës synon të zhvillohet si një autoritet kompetent që mundëson krijimin dhe realizimin e një sistemi bashkëkohor konkurrence.

Autoriteti i Konkurrencës do të punojë për sigurimin e burimeve të duhura financiare, të harmonizohet me mundësinë e realizimit të një autonomie financiare, si parakusht i nevojshëm për një proces vendimmarrje të pavarur.

Të zhvillohen kapacitetet administrative profesionale nëpërmjet kërkesave të larta për marrjen në punë të stafit të ri dhe trajnimin e të gjithë stafit, për të mundësuar ekspertizat juridike dhe ekonomike.

Për përmbushjen e këtyre synimeve, organet kompetente dhe Kuvendi i Shqipërisë duhet të bëjnë ç'është e mundur që të rritet autonomia administrative dhe të sigurohet autonomia në vendimmarrje.

Synime të rëndësishme janë edhe zhvillimi i kulturës së konkurrencës në Shqipëri, bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ngritja ose forcimi i marrëdhënieve me autoritetet e konkurrencës në rajon e më gjerë.

Duke ruajtur pavarësinë ligjore në kryerjen e detyrave Autoriteti i Konkurrencës mban po ashtu marrëdhënie të rregullta dhe periodike me Kuvendin e Shqipërisë. Autoriteti i Konkurrencës raporton periodikisht dhe të paktën një here në vit në Kuvend në Komisionin e Ekonomisë. Në raportimin vjetor analizohet puna e bërë në harkun e 12 muajve, propozimet për përmirësime ligjore apo të politikave që vijnë prej autoritetit si

edhe dëgjohej rekomandimet e Komisionit të Ekonomisë për punën e Autoritetit dhe mbrojtjen më të mirë të Konkurrencës. Në përfundim duke përfshirë të gjitha këndvështrimet Komisioni i Ekonomisë bazuar në propozimet e bëra nga Autoriteti i Konkurrencës si edhe nga ato të mbledhura në seancën dëgjimore Parlamentare harton një projekt rezolutë ku shprehen sugjerimet dhe shqetësimet e konsoliduara për punën e Institucionit. Ky dokument diskutohet dhe miratohet në seancë plenare dhe pas këtij çasti kthehet në gur vlerësimi dhe matje të punës së institucionit si edhe në një instrument objektivash perspektive për t'u zbatuar në punën e ardhshme vjetore.

Përveç raportimit vjetor Kuvendi kërkon informacione periodike të mbarëvajtjes së punës të ecurisë së proceseve si edhe të instrumenteve të zbatimit që Autoriteti përdor në shqyrtimin e çështjeve emergjente të tregut. Po ashtu Autoriteti është palë e thirrur për t'u shprehur në të gjitha seancat dëgjimore pranë Kuvendit kur ka çështje të kompetencës tij apo të fushë-zbatimit të tij. Kështu ka qenë rasti i shqyrtimit të punës së disa institucioneve rregullatorë në seanca Komisionesh Kuvendor, ku AK është thirrur të shprehë pikëpamjet e tij mbi rrugët e bashkëpunimit të plotë me agjensinë përkatëse në funksion të ruajtjes së rregullave të konkurrencës edhe në atë sektor.

Një aspekt i rëndësishëm i punës sonë janë marrëdhëniet me qeverinë që përfshin kryesisht atë qendrore por pa përjashtuar edhe agjencitë e qeverisjes vendore. Kjo sepse një pjesë e madhe e analizave që bëjmë për hetimet tona kanë të bëjnë me akte normative ligjore apo nënligjore, të cilat kanë burimin e tyre por edhe zbatohen nga qeveria. Kështu është pjesë e detyrave tona të shprehemi për efektin konkurrues apo jo që kanë këto akte të reja apo në fuqi prej kohësh. Mendimet tona janë shprehur në vendime të cilat i janë përcjellë qeverisë dhe në raste të veçanta edhe ministrive specifike të interesuara për çështjen konkrete. Vendimet tona në të tilla raste kanë karakterin e udhëzimit dhe qëndron në vlerësimin e qeverisë nëse do t'i përfshijë ato në përmirësimet e saj ligjore të ardhshme. Duhet thënë se ky zë i Autoritetit ka ardhur duke u forcuar dhe konsultimi ka mbetur i hapur me qeverinë. Por edhe e anasjelltas qëndron që d.m.th se edhe qeveria nga ana e saj në respekt të parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe gjithë-përfshirjes duhet të vet kontrollojë punën dhe vendimet e saj në mënyrë që ato të pasqyrojnë parimet e konkurrencës së ndershme si edhe të përfshijë Autoritetin e Konkurrencës në konsultime dhe vendimmarrje si palë të interesuar, sa herë që pritet të ketë reforma ligjore dhe strukturore me efekte mbi konkurrencën. Mbrojtja e Konkurrencës është një shtyllë qendrore për çdo ekonomi të hapur tregu dhe duhet mbrojtur pa kompromis. Një aspekt ku ne presim me shume vëmendje dhe përfshirje nga ana e qeverisë dhe çdo segmenti të saj, janë vendimet mbi përcaktimin dhe dhënien e licencave apo të drejtave ekskluzive firmave private në vend të ish-ndërmarrjeve shtetërore nga qeveria. Këto janë pjesë e kompetencave tona ligjore dhe ushtrimi i tyre kërkon që ne të konsultohemi përpara se çdo akt i ri të ndërmerret apo çdo vendim të bëhet në këtë aspekt. Kjo do të na lejojë ne, të kryejmë punën tonë por do të ndihmojë edhe këto kontratat të jenë më efikase për vendin dhe për qytetarët në çdo rast.

VIII.3 Zbatimi i ligjit

Autoriteti i Konkurrencës vlerëson zbatimin efektiv të ligjit si komponenti më i rëndësishëm i politikës dhe veprimtarisë së tij.

Për këtë, vëmendja do të përqendrohet:

1. në rritjen dhe përmirësimin e hetimeve në raste të veçanta. Veprimtaria e tij do të përqendrohet duke synuar kontrollin :

- për të gjitha marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe ndërmarrjesh dhe praktikave bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat kanë si objekt të tyre ose si pasojë kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës,
- e praktikave abuzive me pozicionin dominues, nga një ose më shumë ndërmarrje,
- e përqendrimeve të ndërmarrjeve, si dhe
- zhvillimin e procedurave investigative në zbatim të ligjit.

2. Për të forcuar efektivitetin e zbatimit të ligjit në raste të veçanta, Autoriteti do të zbatojë marrjen e masave administrative ndaj shkeljeve të konkurrencës, duke përdorur me efektivitet sanksionet dhe gjobat e dhëna në rastet e abuzimit të pozitës dominuese, karteleve dhe kontrollit të përqendrimeve. Nga ana tjetër, Autoriteti i Konkurrencës do të ketë në vëmendje dhe do të inkurajojë të gjitha bizneset që ndihen të diskriminuara në treg të bashkëpunojnë me të. Kur ndërmarrjet marrin pjesë në marrëveshje të ndaluara, por i denoncojnë ato dhe ofrojnë informacionin e nevojshëm do të trajtohen në një program të veçantë të lehtësimit të gjobave deri në heqjen e plotë të sanksioneve ndaj tyre.

Autoriteti e sheh si detyrë të tij ndërgjegjësimin e sistemit gjyqësor për zbatimin sa më të plotë të së drejtës së konkurrencës.

VIII.4 Avokacia dhe rritja e kulturës së Konkurrencës

Veprimtaria për nxitjen e konkurrencës nëpërmjet mekanizmave jodetyrues do të jetë një ndër aspektet e rëndësishme të punës së Autoritetit të Konkurrencës. Ajo do të realizohet nëpërmjet:

1. pjesëmarrjes së dukshme dhe qëndrimit pro-aktiv për hartimin dhe përsosjen e legjislacionit, në përputhje me kërkesat dhe parimet e një konkurrence të lirë dhe efektive. Institucionet politik-bërëse duhet të njoftojnë praktikave të tyre ligjore ose aktet nënligjore pranë Autoritetit, për marrjen e rekomandimeve përkatëse;
2. bashkëpunimit dhe bashkërendimit me entet rregullatorë, duke i paraprirë me nënshkrimin e memorandumeve të mirëkuptimit. Autoriteti i Konkurrencës do të bashkëpunojë me entet rregullatore në shqyrtimin e rasteve konkrete, duke marrë ekspertizën më të mirë të rregullatorëve të fushave dhe duke respektuar legjislacionet përkatëse;
3. vlerësimit të krijimit të një klime të përshtatshme biznesi dhe investimesh, si një ndër objektivat më të rëndësishme të Autoritetit të Konkurrencës;
4. vlerësimit të konsumatorëve dhe shoqatave të tyre, si një aleat tjetër i rëndësishëm i Autoritetit. Aq sa konkurrenca ndihmon konsumatorët, po aq konsumatorët mund ta ndihmojnë konkurrencën. Autoriteti i Konkurrencës ka nevojë për mbështetjen dhe kuptimin nga konsumatorët të interesave që ata kanë, jo vetëm në periudhën afatshkurtër por edhe në atë afatgjatë, për shëndoshjen e konkurrencës dhe një zbatim sa më të mirë të legjislacionit në këtë fushë. Ligji i konkurrencës dhe zbatimi i tij është aleati më i mirë i konsumatorit;
5. ndërgjegjësimin të publikut dhe medias për rolin e konkurrencës si një e mirë

publike për të gjetur aleatët e vërtetë të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe të ndershme në treg;

6. rritjes së aksesit për informacionin në lidhje me ligjin, politikën dhe veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës. Publikimi i vendimeve në faqen e internetit, median e shkruar dhe atë elektronike, deri në përpunimin e një strategjie komunikimi, vlerësohen si kushte për krijimin e një kulture konkurrence edhe në vendin tonë.

VIII.5 Prioritetet afat-shkurtra të Autoritetit të Konkurrencës

Me asistencën e projektit të financuar nga UNCTAD, Autoriteti i Konkurrencës në periudhën afatshkurtër do të përqendrohet në realizimin e rekomandimeve të raportit të vlerësimit të UNCTAD si vijon:

- vazhdimi i frymës së politikës kombëtare të konkurrencës drejt standardeve të BE-së,
- krijimin e kapaciteteve për një kontroll efektiv për ndihmën shtetërore,
- rritjen e efektivitetit në mbrojtjen e konsumatorëve (këto dy rekomandime për qeverinë),
- reduktimin e kriterëve për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës,
- vazhdimin e pavarësisë së Autoritetit të Konkurrencës,
- përafrimin e kuadrit ligjor për njoftimin e përqendrimeve,
- rritjen e ndërgjegjësimit publik për politikën anti-kartel,
- një politikë më atraktive për lehtësimin nga gjambat,
- luftën kundër karteleve në prokurimet publike në bashkëpunim me institucionet e ngarkuara me prokurimet publike dhe anti-korrupsionin,
- vazhdimin e forcimit të instrumenteve për avokatinë e konkurrencës,
- rritjen e kulturës së konkurrencës te operatorët ekonomikë,
- përfshirjen e rregullores për vendimet me angazhime,
- rritjen e ndërgjegjësimit publik për kërkesën e biznesit për zbatimin e ligjit të konkurrencës,
- rritjen e kapaciteteve për inspektimet,
- ngritjen e funksionit të chief-economist,
- ngritjen e një sistemi eficient për ekzekutimin e gjobave të Autoritetit të Konkurrencës (rekomandim për qeverinë),
- një sistem karriere dhe incentiva për stafin e Autoritetit të Konkurrencës,
- vazhdimin e projekteve të asistencës teknike,
- trajnimin e gjyqtarëve dhe
- ngritjen e një biblioteke në Autoritetin e Konkurrencës.

Bashkëpunimi mes UNCTAD dhe Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës do të konkretizohet me fillimin e një projekti të asistencës teknike (tetor 2015) dhe që ka për synim zbatimin e rekomandimeve, ngritjen profesionale të stafit të Autoritetit dhe rritjen e ndërgjegjësimit të biznesit dhe institucioneve të tjera publike mbi rëndësinë e zbatimit të ligjit dhe politikës së konkurrencës në funksion të një ekonomie tregu funksionale.

VIII. BIBLIOGRAFI

1. Ligji 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”
2. APEC Principles to Enhance Competition and Regulatory Reform
3. Competition policy implimentation in transition economies: an empirical assessment –by Mark A. Dutz and Maria Vagliasindi
4. Competition across transition economies an enterprise –level analysis of the main policy and structural determinants- Maria Vagliasindi.
5. The WORLD BANK Transition The First Ten Years-Analysis and Lessons for Eastern Europe and the Former Soviet Union
6. International Bank For Recontstruction And Development International Development. Country Assitance Strategy for the Republic of Albania for the Period FY06-FY09
7. Heqja e pengesave administrative, procesi vazhdueshem per permiresimin e klimes se biznesit.-Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes
8. Programi i Qeverisë 2005-2009
9. The 5th UNCTAD Conference –Opening Statement by the President of the Turkish Competition Authority.
10. Politika Kombëtare e Konkurrencës
11. Marrëveshja e Stabilizim Asocimit.
12. Action Plan for the Implementation of the European Partnership Priorities
13. Plani i zbatimit të MSA-së
14. Vendimet, vlerësimet e Komisionit të Konkurrencës nga marsi 2004 e deri tani.
15. Faqet e internetit të OECD-së, ICN-së, Komisionit Evropian, Drejtorisë së Përgjithshme të Konkurrencës, UNCTAD-it, Bankës Botërore, Paktit të Stabilitetit.
16. Politika e konkurrencës, Itali (La politica della concorrenza nell’economia Italiana: profili generali e linee di intervento);
17. Politika e konkurrencës, Turqi
18. Twinning Project, financed by IPA 2008, “Support for the Albanian Competition Authority and State Aid Department”
19. Fjalime të autoriteteve të Komisionit Evropian për konkurrencën;
20. Publikime të Bankës së Shqipërisë, ERT-së, ERU-së, ERE-s e të enteve të tjera rregullatore.
21. Paraqitjet e materialeve të zbatimit të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
22. Raportet vjetore të Autoritetit të Konkurrencës për vitet 2011-2015.
23. OECD- Competition Law and Policy
24. Platforma rregullatore në Itali.
25. Regulation(EEC) no 4064/89 “Merger Procedure”;
26. Official Journal of the European Union;
27. A framework for the design and implementation of Competition Law and Policy.
28. Competition Law and Policy in Sowth and Eastern Europe- OECD 2011.
29. Politika e konkurrencës në Rumani.
30. Politika dhe Ligji i Konkurrencës në Turqi.
31. The economics of industrial Organisation-William G Shepherd
32. Konferenca ndërkombëtare ”Politikat e konkurrencës dhe të ndihmës shtetërore në kuadrin e hyrjes në BE”-Dr. Ansgar Held,CE
33. Grupimet dhe ekonomia e re e konkurrencës, Revista e Biznesit e Harvardit,

- Boston/Dhjetor 1998, Michael E.Porter.
34. Integrimi i Infrastrukturës së Tregjeve Evropiane të Kapitaleve dhe Ligjit të Konkurrencës.
 35. Mario Monti, Fjala në takim me Shoqatën e Menaxherëve të Investimeve të Klientëve Privatë dhe Ndërmjetësve të Bursës, Bruksel
 36. The economist, Konkurrenca është gjithçka, 06-12 dhjetor 2003, fq 74.
 37. Politikat konkurruese dhe problemet e hyrjes në tregjet transmetuese.
 38. “Mekanizmi i këshillimit të komunikacioneve elektronike”, parashikuar nga neni 7 i direktivës 2002/21/EC
 39. Mario Monti, ish-Komisioner për Konkurrencën, “Konkurrenca dhe rregullimi në kuadrin ligjor”;
 40. Raporti i OECD-së për konkurrencën, 2004
 41. Mario Monti, ish-Komisioner për Konkurrencën, “Konferenca për përqendrimet dhe politikat bankare”.
 42. Bradley R. Schiller: “The micro economy Today”.
 43. UNCTAD (2015) Voluntary Peer Review of Competition Law and Policy: Albania, Gjeneve, 2015.